

ГОДИШЕН ИЗВЕШТАЈ
RAPORTI VJETOR
ANNUAL REPORT

2016



Црвен крст на Република Македонија
Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë
Macedonian Red Cross

PËRMBAJTJA:

HYRJE	43
NGRITJA E KAPACITETEVE TË SHOQATË[S NACIONALE DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR I PARTNERITETIT	44
TRANSPARENTË PARA PUBLIKUT.....	48
VEPRIMET HUMANITARE.....	49
184 PROJEKTE TË VOGLA NË KUADËR TË PROGRAMIT KRYQI I KUQ NË AKSION – PROMOVIMI I VLERAVE HUMANE (KKA-PVH)	50
VULLNETARIZMI NË KRYQIN E KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË.....	51
GATISHMËRIA DHE VEPRIM GJATË KATASTROFA.....	52
MBËSHTETJA HUMANITARE PËR POPULLSINË MIGRUESE.....	55
PËRMBYTJET NË MUAJIN GUSHT TË VITIT 2016 NË RAJONIN E SHKUPIT DHE TETOVËS.....	58
VEPRIMTARIA SOCIALE-HUMANITARE.....	60
VEPRIMTARIA PREVENTIVE-SHËNDETËSORE.....	66
NDIHMA E PARË	69
DHURIMI I GJAKUT	70
AKTIVITETET E TË RINJVE.....	73
MOBILIZIMI I FONDEVE TË SEKTORIT TË KORPORATAVE.....	74
SHËRMBIMI PËR KËRKESA	76
RAPORT FINANCIAR PËR VITIN 2016	78



HYRJE

Për të qenë i madh duhet të bësh gjëra të vogla që do të kontribuojnë për të realizuar një ndryshim pozitiv në jetën e njerëzve. Kryqi i kuq i Maqedonisë nëpërmjet rrjetit të tij të organizatave komunale të Kryqit të kuq dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit vazhdon të jetë i pranishëm në jetën e përditshme të njerëzve që përballen me sfida të ndryshme dhe me vullnetarët e tij ka arritur që të ngjallë buzëqeshjen në mesin e njerëzve, të cilët besonin se ishin harruar nga të gjithë. Kryqi i kuq dha kontribut në promovimin e iniciativave vullnetare për fëmijët për të zgjuar dëshirën e tyre për punë humanitare dhe për një hap pozitiv përpara në jetën e tyre. Ne i kemi mësuar të rinjtë për vlerat pozitive dhe kemi iniciuar bashkimin e tyre për realizimin e praktikave pozitive në mjediset lokale.

Organizata jonë ka dhënë kontribut të veçantë në promovimin e jetës së sigurt dhe zbatimin e aktiviteteve shëndetësore preventive për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të popullsisë. Kemi promovuar dhurimin e gjakut dhe kemi mësuar njerëzit si të japin ndihmë të parë. Fëmijët i kemi mësuar si të mbrohen nga sëmundjet e ndryshme dhe të respektojnë njëri-tjetrin. Kemi qenë në fshatra dhe qytete dhe kemi mësuar popullsinë si të përballen me sfidat e caktuara shëndetësore që janë rezultat i jetës moderne.

Aktivitetet sociale gjithashtu kanë qenë pjesë thelbësore e punës sonë vitin e kaluar. Kemi qenë me gjeneratën e moshës së tretë, kemi qenë me fëmijët në rrugë, me personat me aftësi të kufizuara, me rastet sociale, me të pastrehët, me të vetmuarit dhe individët e ndarë si rezultat i migrimeve. Së bashku me partnerët tanë të sektorit të korporatave, organizatat partnere të Lëvizjes dhe agjencitë ndërkombëtare, ne kemi marrë mbështetje të konsiderueshme për iniciativat e ndryshme për të përmirësuar jetën e kategorive të ndryshme të popullsisë së rrezikuar.

Me mbështetjen e madhe që kemi marrë nga partnerët dhe popullsia e Republikës së Maqedonisë, kemi qenë me të përmbyturit në Shkup dhe Tetovë dhe u kemi ndihmuar atyre kur ata e kishin më vështirë. Mbështetja jonë për këtë grup qëllimor vazhdon ende falë donacioneve të ofruara nga organizatat partnere. Të punësuarit dhe vullnetarët tanë vazhduan të jenë personat më të afërt në të cilët mund të mbështeten migruesit. Ata janë kujdesur sadopak për të përmirësuar jetën e përditshme të migruesve në qendrat e strehimit dhe për të plotësuar nevojat më të mëdha të migruesve të parregullt, të cilët vazhdojnë nën ombrellën e shpresës për një ardhmëri më të sigurt dhe më të mirë nëpër rrugën e Ballkanit drejt vendeve të Evropës Perëndimore.

Ne kemi bërë edhe diseminimin (shpërndarjen e informacionit), rivendosjen e lidhjeve familjare dhe shpëtimin në ujë dhe në mal. Kemi qenë aktivë në ngritjen e vetëdijes së popullsisë për ndryshimet klimatike dhe uljen e rreziqeve nga katastrofat dhe shumë aktivitete të tjera.

Ju ftojme në faqet e raportit tonë vjetor për t'u njohur me punën e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë në vitin 2016, të lexoni për të arriturat tona, sfidat tona dhe kontributin tonë modest për një të nesërme më të mirë të mijëra njerëzve të cilët ishin përdorues të shërbimeve tona.


Dr. Milčo Trajkov
Kryetar


d-r Sait Saiti
Sekretar i Përgjithshëm

NGRITJA E KAPACITETEVE TË SHOQATËS NACIONALE DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR I PARTNERITETIT

Aktivitetet zhvillimore të Shoqatës nacionale në vitin 2016 kanë qenë të drejtuara në përmirësimin e kapaciteteve të organizimit dhe avancimin e kualitetit të shërbimeve për kategoritë e ndryshme të shfrytëzuesve të shërbimeve. Aktivitetet ishin të drejtuara në sigurimin e mbështetjes nga partnerët për programet e Shoqatës nacionale, avancimin e shkathhtësisë dhe kompetencave të burimeve njerëzore, thellimin e bashkëpunimit me partnerët e Kryqit të kuq brenda dhe jashtë vendit dhe përfshirjen e metodologjive të reja të zhvillimit të Shoqatës nacionale.

Viti u shënuar nga disa operacione të mëdha për mbështetjen e popullsisë së prekur në vend nga katastrofat natyrore, kryesisht nga përmbytjet në rajonin e Shkupit dhe Tetovës dhe operacioni për mbështetjen e popullsisë së migruesve që kalon transit apo qëndron përkohësisht në Republikën e Maqedonisë. Për këtë qëllim janë realizuar shumë kontakte dhe aktivitete ndërkombëtare për të siguruar mbështetjen ndërkombëtare të partnerëve. Një pjesë e mbështetjes ndërkombëtare është drejtuar në përmirësimin e kapaciteteve operative të shoqatës sonë nacionale për t'u përballur më mirë me të gjitha sfidat.

Aktivitetet më të rëndësishme që veçohen në pjesën e organizimit dhe zhvillimit dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar në vitin 2016 janë këto:

Vizita e delegacionit të Kryqit të kuq të Austrisë.

Në periudhën nga 7 deri më 11 shkurt, një delegacion i Kryqit të kuq të Austrisë vizitoi Kryqin e kuq të Maqedonisë në lidhje me përgatitjen e aplikacionit për një projekt të Fondit Madad të Bashkimit Evropian. Gjatë vizitës janë realizuar takime me shumë organizata vendore dhe ndërkombëtare dhe institucione shtetërore, dhe është punuar në përgatitjen e një aplikacioni të projektit për sigurimin e një mbështetjeje të mundshme për popullsinë migruese në RM.

Memorandumi i bashkëpunimit me Universitetin "Shën Klimenti i Ohrit" – Manastir. Kryqi i kuq i R. së Maqedonisë i përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm Dr. Sait Saiti dhe Universiteti "Shën Klimenti i Ohrit" – Manastir i përfaqësuar nga rektori prof. Dr. Sasho Korunovski nënshkruan një memorandum bashkëpunimi më 16.03.2016, i cili edhe njëherë konfirmoi dhe përforcoi bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve. Bashkëpunimi do të zhvillohet në fushën e promovimit dhe avancimit të dhurimit vullnetar të gjakut, realizimin e aktiviteteve të ndihmës së parë, avancimin e përfshirjes sociale, promovimin e parimeve themelore të Lëvizjes, realizimin e aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes publike për mbrojtjen dhe vetëmbrojtjen në rast katastrofash dhe të tjera.

Memorandumi i bashkëpunimit me Universitetin MIT - Shkup. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë, i përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm Dr. Sait Saiti dhe Universiteti MIT – Shkup, i përfaqësuar nga rektori prof. Dr. Marian Stevanovski më datë 30.03.2016 nënshkruan memorandum bashkëpunimi të të dy institucioneve. Disa nga aktivitetet që do të realizohen janë promovimi dhe avancimi i dhurimit vullnetar të gjakut, realizimi i aktiviteteve të ndihmës së parë, avancimi i përfshirjes sociale dhe i kulturës së mosdhunës dhe paqes, promovimi i parimeve themelore të Lëvizjes Ndërkombëtare të



Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqë, promovimi i vlerave humane, realizimi i aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes publike për mbrojtje dhe vetëmbrojtje në rast katastrofash dhe të tjera. Qëllimi i këtij Memorandumi është inkurajimi i sistemit arsimor në Republikën e Maqedonisë për të marrë pjesë në mënyrë aktive në numrin e madh të aksioneve që i zbaton Kryqi i kuq e që kanë karakter humanitar.

Takim pune për migrimet. Në periudhën nga 30.03.2016 deri më 02.04.2016, një delegacion dyanëtarësh i Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë mori pjesë në takimin koordinues për migrimet në Vjenë, Austri. Qëllimi i takimit ishte shkëmbimi i përvojave për operacionin aktual për migruesit në rajonin e Evropës. Takimi është organizuar nga Federata Ndërkombëtare e Kryqit dhe Kuq dhe Kryqi i Kuq i Austrisë. Në këtë takim është diskutuar për aktivitetet në fushën e kujdesit preventiv shëndetësor, rivendosjen e lidhjeve familjare, ndihmat humanitare dhe logjistika, kujdesi për grupet qëllimore dhe apeli për migrime. Kryqi i Kuq i RM-së bëri prezantim në temën kujdesi shëndetësor për migruesit në Republikën e Maqedonisë.

U nënshkrua marrëveshje bashkëpunimi me Korpusin e Paqes. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë, i përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm Dr. Sait Saiti dhe Korpusi i Paqes në Maqedoni, i përfaqësuar nga drejtori i Korpunit të Paqes në Maqedoni, Mark Hanafin, më datë 05.05.2016 nënshkruan memorandum bashkëpunimi me të cilin janë treguar qëllimet e të dyja palëve për bashkëpunim, nëpërmjet realizimit të Programit të Zhvillimit të Komuniteteve dhe emërimit të vullnetarëve të Korpunit të Paqes për realizimin e një bashkëpunimi të mundshëm dhe aktivitetet në organizatat komunale të Kryqit të Kuq për mbështetjen e grupeve të ndryshme qëllimore.

Takimi koordinues me sekretarët e organizatave komunale të Kryqit të kuq. Në periudhën 29-31 maj në Strugë u zhvillua një punëtori konsultative me sekretarët e organizatave komunale të Kryqit të kuq. Në punëtorinë morën pjesë 32 përfaqësues të organizatave komunale të Kryqit të kuq. Në këtë punëtori janë diskutuar tema të tilla si kriza migruese, menaxhimi i vullnetarëve, dhurimi i gjakut, ndihma e parë, avancimi i kornizës normative të Shoqatës nacionale etj.

Mirënjohje nga ARM-ja. Me rastin e shënimit të Ditës së ARM-së më 18 gusht, Shefi i Shtatmadhorisë së Armatës së Republikës së Maqedonisë i ndau Sekretarit të përgjithshëm të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë, Dr. Sait Saiti, Distinktiv të artë të Armatës së RM-së për partneritetin, koordinimin dhe bashkëpunimin me Kryqin e kuq të Republikës së Maqedonisë.

Takim pune me ambasadorin e Izraelit në Republikën e Maqedonisë. Më 19 shtator të vitit 2016 Kryqin e kuq të Republikës së Maqedonisë e vizitoi ambasadori i Izraelit, Dan Orian. Mysafiri i lartë u prit nga Presidenti i Kryqit të kuq Dr. Millço Trajkov dhe Sekretari i përgjithshëm, Dr. Sait Saiti. Gjatë takimit u prezantua puna e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë dhe u diskutuan mundësitë për vendosjen e bashkëpunimit me Magen David Adom të Izraelit si dhe zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta sidomos në mesin e të rinjve në drejtim të avancimit të paqes dhe tolerancës dhe vlerave humane në mesin e të rinjve. Ambasadori Dan Orian shprehu falënderim të veçantë për bashkëpunimin e realizuar me Kryqin e kuq të Republikës së Maqedonisë – Organizata komunale e Manastirit me rastin e realizimit të projektit për rinovimin e Varrezave hebraike në Manastir.



Vizitë studimore Kryqit të kuq të Sllovenisë dhe Kryqit të kuq të Kroacisë. Ndërmjet 08.09-12.09.2016 një delegacion i Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë u bëri vizita studimore Kryqit të kuq të Sllovenisë dhe Kryqit të kuq të Kroacisë. Qëllimi i kësaj vizite ishte shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira lidhur me operacionin për mbështetjen e migruesve në rrugën e Ballkanit. Gjithashtu gjatë vizitave u shkëmbyen përvojat e zbatimit të veprimtarive programore në shoqatat nacionale dhe sfidat me të cilat janë duke u përballur organizatat në punën e përditshme e lidhur me veprimtaritë e ndryshme programore. Takimet e punës u realizuan në Lubjanë dhe Zagreb në prani të strukturave më të larta drejtuese dhe udhëheqëse të organizatave si dhe në prani të shërbimeve profesionale.

Bashkëpunimi me Lidhjen e Shoqatave të Pensionistëve të Maqedonisë. Më datë 18.10.2016 Kryqin e kuq e ka vizituar një delegacion i Lidhjes së Shoqatave të Pensionistëve të Republikës së Maqedonisë i udhëhequr nga kryetari z. Dragi Argirovski. Me rastin e jubileut 70 vjet (1946-2016) të ekzistimit të Lidhjes së Shoqatave të Pensionistëve të Maqedonisë, kryetari i Lidhjes z. Dragi Argirovski i dorëzoi një pllakë sekretarit të përgjithshëm të Kryqit të kuq të RM-së Dr. Sait Saiti për kontributin e shquar të Kryqit të kuq në zhvillimin e organizimit të pensionistëve në Maqedoni.

Vizitë bilaterale Kryqit të kuq të Kroacisë. Në periudhën nga 20 deri më 23 tetor, Kryqin e kuq të Republikës së Maqedonisë e ka vizituar një delegacion i lartë i Kryqit të kuq të Kroacisë i udhëhequr nga kryetari Dr. Josip Jeliç. Gjatë vizitës janë realizuar shumë takime të punës me udhëheqjen dhe drejtorinë e Shoqatës nacionale, me ç'rast është diskutuar bashkëpunimi aktual dhe mundësitë e avancimit të bashkëpunimit në periudhën e ardhshme. Gjatë qëndrimit në Maqedoni mysafirët vizituan selinë e Shoqatës nacionale, Kryqin e kuq të qytetit të Shkupit, Organizatën komunale të Kryqit të kuq të Ohrit dhe Kryqin e kuq të Manastirit.

Punëtorja me sekretarët e organizatave komunale të Kryqit të kuq. Punëtorja është zhvilluar ndërmjet 07-09.11.2016 dhe në të kanë marrë pjesë sekretarët e 30 OKKK-ve dhe KKQ-ja e Shkupit. Punëtorja i është kushtuar shkëmbimit të pikëpamjeve dhe propozimeve për planifikimin e programeve në vitin 2017, aktiviteteve për mbledhjen e partneritetit të KKRМ, ndarjen në mes vete të gjetjeve të vlerësimit dhe analizës së OKKK, prezantimit të aktiviteteve për mbështetjen e migruesve që kalojnë transit nëpër Republikën e Maqedonisë, aktiviteteve për mbështetjen e popullsisë së prekur nga përmbytjet në Shkup dhe Tetovë, prezantimit të projekt-versionit të Statutit të KKRМ, dhe është mbajtur një takim i rregullt koordinues i përmbajtjeve programore të KKRМ, siç janë ndihma e parë, dhurimi i gjakut dhe përmbajtje të tjera zhvillimore të organizatës.

Nënshkrimi i Memorandumit të bashkëpunimit me Ambasadën e Republikës së Francës. Më datë 25.11.2016 Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë i përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm Sait Saiti dhe Ambasada e Republikës së Francës në Maqedoni e përfaqësuar nga ambasadori, Kristian Timonie, kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi me të cilin edhe njëherë është konfirmuar dhe përforcuar bashkëpunimi në mes të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë dhe Ambasadës së Francës në Maqedoni. Gjatë vizitës sekretari i përgjithshëm Sait Saiti ka dhënë pasqyrë të shkurtër të aktiviteteve aktuale në Kryqin e kuq dhe janë shkëmbyer përvojat e bashkëpunimit të deritashëm, si dhe planet dhe mundësitë për një bashkëpunim të ardhshëm në mes të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë dhe Ambasadës së Francës në Maqedoni.





Vizitë studimore Kryqit të kuq të Austrisë dhe Kryqit të kuq të Kroacisë. Në periudhën ndërmjet 07.12-12.12.2106 një delegacion i Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë i bëri vizita studimore Kryqit të kuq të Austrisë dhe Kryqit të kuq të Kroacisë. Qëllimi i vizitës ishte shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira lidhur me operacionin për mbështetje të migruesve në rrugën ballkanike. Gjithashtu gjatë vizitave janë shkëmbyer përvojat e zbatimit të veprimtarive programore në shoqatat nacionale dhe sfidat me të cilat janë përballur organizatat në punën e tyre të përditshme lidhur me veprimtaritë e ndryshme programore. Takimet e punës janë realizuar në Vjenë dhe Zagreb në prani të strukturave më të larta udhëheqëse dhe administrative të organizatave, si dhe në prani të shërbimeve profesionale. Theks i veçantë në këto diskutime është vënë në operacionet aktuale për mbështetjen e migruesve.

Mbledhjet e Këshillit ekzekutiv dhe Kuvendit të KCRM. Gjatë vitit 2016 janë mbajtur tetë mbledhje të Këshillit ekzekutiv dhe dy mbledhje të Kuvendit të Shoqatës nacionale. Në këto mbledhje janë shqyrtuar dhe miratuar një sërë dokumentesh dhe vendimesh me interes për funksionimin e organizatës.

Vizitat e përfaqësuesve të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të kuq dhe Federatës Ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe. Gjatë këtij viti disa herë Shoqatën nacionale e kanë vizituar përfaqësues të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të kuq dhe Federatës Ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe kryesisht për shkak të koordinimit të suksesshëm të operacionit për të ndihmuar popullsinë e migruesve që qëndrojnë ose kalojnë transit në Republikën e Maqedonisë.

Vlerësimi dhe analiza e organizatave komunale të Kryqit të kuq dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit. Në periudhën midis muajve prill dhe dhjetor të vitit 2016 është zbatuar vlerësimi dhe analiza e katërt e punës së Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë për realizimin e aktiviteteve programore të njësive integrale të Organizatës për periudhën 2012-2015. Ky projekt u financua nga Kryqi i kuq i Gjermanisë. Në kuadër të projektit janë bërë vizita në terren në të gjitha organizatat komunale të Kryqit të kuq dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit dhe janë bërë intervista dhe biseda me strukturën udhëheqëse dhe administrative të organizatave lokale, si dhe anketa me grupe qëllimore, me përfaqësues të Këshillit ekzekutiv, të Kuvendit, të rinjtë dhe vullnetarët e Organizatës. Gjithashtu për qëllimet e këtij projekti është kryer një anketë me organizatat e jashtme partnere të Kryqit të kuq në komunat me qëllim të hulumtimit të mendimit të partnerëve mbi punën e Kryqit të kuq në nivelin lokal. Në kuadër të projektit është shtypur një botim në tri gjuhë i raportit në 360 kopje.

Rishikimi i Statutit të KCRM. Shoqata nacionale formoi grup pune të përbërë nga njësi të ndryshme strukturore të Organizatës, i cili gjatë vitit 2016 ka punuar në mënyrë aktive në rishikimin e tekstit të Statutit të KCRM. Gjatë këtij viti grupi i punës ka organizuar shumë takime pune në të cilat është punuar në ndryshimin dhe plotësimin e tekstit të Statutit duke përdorur statute të shumë shoqatave të tjera nacionale, udhëzime për punimin e statuteve të shoqatave nacionale të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, si dhe instruksione të marra nga Komisioni i Përbashkët i Federatës Ndërkombëtare të KNKK për statutet e shoqatave nacionale. Teksti i ri i Statutit duhet të finalizohet në fillim të vitit 2017.

TRANSPARENTË PARA PUBLIKUT

Informimi në vitin 2016 kontribuoi për vendosjen dhe mirëmbajtjen e sistemit të komunikimit dhe informimit për një bashkëpunim më të afërt në mes të KCRM dhe mjeteve të informimit publik. Në kuadër të sistemit informativ KCRM gjithashtu ka ofruar një informim më të gjerë të publikut për të informuar në mënyrë të vazhdueshme qytetarët për aktivitetet tona. Si metodë të suksesshme të punës kemi përdorur mënyrën moderne të informimit duke arritur për të tërhequr vëmendjen e publikut. Komunikimi i jashtëm është realizuar përmes njoftimeve dhe informatave të ndryshme për mediat e shtypura dhe elektronike, nëpërmjet organizimit të konferencave të shtypit, brifingjeve e të tjera.

Rrjetat sociale të KCRM. – Avancimi i faqes FB dhe ridizajnimi i faqes së internetit të KCRM mundësoi hapësirë për të publikuar shumë informacione të larmishme me një

strukturë që në shënjestër ka kategoritë e ndryshme të vizitorëve. Pasurimi i ueb-faqes me përmbajtje interesante dhe ndërvepruese kontribuoi që të tërheqë dhe të jetë e vizituar nga të gjitha strukturat e qytetarëve. Vullnetarët dhe qytetarët e tjerë vizitojnë faqet me qëllim që të arrijnë te informacionet për ngjarjet, vendet për të dhuruar, madje edhe për mënyrën e përfshirjes në Organizatën dhe në aktivitetet e saja.

E-gazeta Info – Botimet javore të gazetës elektronike të Kryqit të kuq tanimë dhjetë vjet janë shembull i një mjeti të suksesshëm të informimit të vullnetarëve tanë, partnerët, bashkëpunëtorët dhe mbështetësit e aktiviteteve që ne i realizojmë në nivelin lokal, nacional dhe ndërkombëtar. Në vitin 2016 janë përgatitur 54 numra të E-gazetës Info me gjithsej 600 tekste të publikuara. Përveç përcjelljes së 71.418 adresave e-mail, ajo është

përditësuar dhe publikuar rregullisht në ueb-faqen tonë duke pasur kështu mundësi publiku i përgjithshëm në Republikën e Maqedonisë për të mësuar për aktivitetet tona.

Punëtorja me mediat – Duke i pasur parasysh ndodhitë aktuale me krizën migruese më 2 qershor Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë me mbështetjen e Federatës Ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe ka organizuar një punëtori me dymbëdhjetë përfaqësues të medimeve anembanë vendit për të bërë fushatë për ngritjen e vetëdijes së popullsisë për nevojat humane të migruesve dhe për aktivitetet për mbështetjen e tyre që është duke i realizuar Shoqata nacionale. Në këtë punëtori është promovuar edhe spoti “Stop indiferentizmit – ta ruajmë humanitetin” dhe ky spot është emetuar falas nga shumë media.



Publikimet – Me rastin e javëve tradicionale të përcaktuara në Ligjin e Kryqit të kuq, si dhe numrit të madh të aktiviteteve të projektit dhe dokumenteve strategjike, në kuadër të veprimtarisë botuese të Shoqatës nacionale edhe sivjet rregullisht janë pasuruar me materiale kreative dhe atraktive arsimore në formë të broshurave, flaerëve, posterëve, doracakëve, markave me pagesë shtesë dhe me forma të tjera të botimeve. Duke pasur në vete mesazhe humanitare apo udhëzimet e veprimit janë arritur rezultate të rëndësishme tek grupet qëllimore, si dhe është ndikuar në mënyrë pozitive në ngritjen e imazhit të Shoqatës nacionale. Me qëllim që të gjitha publikimet të jenë më afër për personat për të cilët janë dedikuar edhe sivjet KCRM të gjitha botimet e saja i botoi në gjuhën maqedonase dhe shqipe dhe disa prej tyre edhe në gjuhën angleze

VEPRIMET HUMANITARE

Aktivitetet e diseminimit kanë për qëllim përhapjen e njohurive për Lëvizjen ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, ngritjen e sistemit për kryerjen e diseminimit të përgjithshëm, diseminimin DHN dhe diseminimin DHN për grupet e veçanta qëllimore.

Kryqi i kuq i RM-së edhe sivjet i është bashkuar fushatës globale të Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe me moton "Gjithkund për të gjithë". Krenimi qëndror i 8 majit – Ditës Botërore të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe është mbajtur në selinë e Kryqit të kuq të RM-së, me ç'rast është promovuar pulla postare "Gjithkund për të gjithë" që është lëshuar nga SHA Posta e Maqedonisë.

Në OKKK: Manastir, Ohër, Gostivar, Strumicë dhe Veles, u hapur ekspozita e Kryqit të kuq të RM-së që përmban shënime, fotografi ngjarjesh, aktivitete dhe personalitete që i kanë dhënë shenjë të veçantë periudhës njëzetvjeçare, dhe aktivitete nga njohja ndërkombëtare dhe anëtarësimi i plotë i Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë në Federatën ndërkombëtare. Është projektuar filmi i përgatitur në bashkëpunim me Televizionin e Maqedonisë dhe mbështetja për sigurimin e dokumentacionit të duhur lidhur me Ligjin për Kryqin e kuq të Republikës së Maqedonisë është marrë nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë.

Bashkëpunimi me institucionet kompetente është duke vazhduar dhe është shumë i rëndësishëm jo vetëm për promovimin e Kryqit të kuq, por edhe për të theksuar rolin e Organizatës si partnere dhe ndihmëse e pushtetit. Në Memorandumet e bashkëpunimit të lidhura në mes të Kryqit të kuq të RM-së dhe ministrisë dhe institucionit përkatës, diseminimi është aktivitet kryesor për t'i bërë të njohura për strukturat dispozitat e Konventave të Gjenevës dhe Protokollit shtesë dhe Të Drejtën Humanitare Ndërkombëtare.

Në garnizonet në Shkup, Kumanovë, Tetovë dhe Kërçovë, përfaqësuesit e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë kanë mbajtur ligjëratat me prezantime dhe kanë dhënë një video-film për diseminimin dhe gatishmërinë dhe të vepruarit me rastin e katastrofave. Grupi qëllimor i dëgjuesve kanë qenë personat me uniformë me grada dhe ushtarët, të cilët me interesim kanë ndjekur ligjëratat dhe kanë shprehur kënaqësi për bashkëpunimin. Në pjesën e diseminimit pjesëmarrësit janë njohur me rolin dhe mandatin e Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, KNKK, FNKKGJK dhe Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë, emblemën e Kryqit të kuq dhe të Drejtën Humanitare Ndërkombëtare në lidhje me Konventat e Gjenevës dhe Protokollit shtesë. Për nevojat e fondit të bibliotekës në kazemat, personave përgjegjës të angazhuar për organizimin u janë dhënë ekzemplarë të broshurës "Misioni i vazhdueshëm humanitar" dhe Konventat e Gjenevës dhe Protokollit shtesë.

Me ftesë të Muzeut Ushtarak të Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë mori pjesë në ekspozitën MERL LE UOJ – Fotografi nga Maqedonia – Kryqi i kuq amerikan në Maqedoni gjatë Luftës së Parë Botërore. Pjesëmarrja ishte në formë të ekspozimit të ekspozateve, fotografive dhe objekteve që pasqyrojnë një pjesë të bashkëpunimit me Kryqin e kuq amerikan, Ambasadën amerikane në Republikën e Maqedonisë, si dhe me qytetarë amerikanë që në mënyrë vullnetare kryejnë aktivitete të Kryqit të kuq. Ekspozita u organizua nga Muzeu Ushtarak në objektin e Muzeut Maqedonia dhe u mbajt më 25 shkurt në prani të një numri të madh përfaqësuesish të jetës publike. Ekspozitën e hapi E.T. Zoran Jolevski ministër i Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë, ndërkaq të pranishmëve iu drejtua edhe E.T. Xhes L. Bejli, ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Republikën e Maqedonisë.

Komiteti nacional i të Drejtave Humanitare Ndërkombëtare (DHN) me seli në Kryqin e kuq të RM-së i kryesuar nga përfaqësuesi i Ministrisë së Arsimit në periudhën midis viteve 2014-2016 ka mbajtur 4 takime të punës. Trupi ka emëruar anëtarë të rinj nga ministrinë përkatëse dhe ka filluar procedurën për miratimin e programit të ri të punës së trupit për periudhën e viteve 2017-2018.

Komiteti nacional i DHN-së me ftesë të Ministrisë së Punëve të Jashtme ka emëruar kandidatin z. Vladimir Ortakovski, anëtar të Komisionit ndërkombëtar për verifikimin e fakteve të karakterit humanitar nga Republika e Maqedonisë.

Në planin ndërkombëtar në periudhën midis 6-7 tetorit të vitit 2016 në Sarajevë, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të kuq ka organizuar një punëtori rajonale për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës së Kryqit të kuq dhe ratifikimin e marrëveshjeve në fushën e së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare nga ana e vendeve në të cilat funksionojnë shoqatat nacionale. Në këtë punëtori mori pjesë një përfaqësues i Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë i cili prezantoi punën e Shoqatës nacionale në fushën e diseminimit.



184 PROJEKTE TË VOGLA NË KUADËR TË PROGRAMIT KRYQI I KUQ NË AKSION – PROMOVIMI I VLERAVE HUMANE (KKA-PVH)



Programi Kryqi i kuq në aksion – Promovimi i vlerave humane (KKA-PVH) është një mjet për rekrutimin dhe mbajtjen e vullnetarëve dhe gjithashtu përfaqëson një model diseminimi-komunikimi për të punuar me të rinjtë, ndërkaq në vitin 2016 është mbështetur nga programi i Civika Mobilitas. Në kuadër të ciklit të vitit të kaluar janë organizuar 155 trajnime, nga të cilat 50 vetëm për diseminimin e të rinjve. Arsimin e përgjithshëm e kanë kaluar gjithsej 1.274 të rinj prej të cilëve 1.108 kanë bërë projekte të vogla për të mirën e komunitetit. Në kuadër të Programit funksionon ekipi i instruktorëve i përbërë nga 32 anëtarë dhe ekipi i diseminatorëve i përbërë nga 46 anëtarë.

Janë punuar 184 projekte të vogla për një periudhë prej tre muajsh përmes së cilëve janë ndihmuar 3.790 persona që kanë pasur nevojë për një ndihmë të caktuar. Disa nga projektet kishin për qëllim zbutjen e problemeve, por disa prej tyre edhe zgjidhjen e tyre në mënyrë të përhershme (punësimin e personave të familjeve, rinovimin e shtëpive, rinovimin e qendrave për personat me nevoja të veçanta, organizimin e koncerteve të përbashkëta për promovimin e kulturës dhe gjuhës). Në një projekt janë siguruar mjete financiare për një djalë 21-vjeçar për të bërë pagesën e provimit të shtetit për të marrë licencë pune. Në Shkup të rinjtë kanë bërë një platformë të pjerrët të qasshme për nxënësit me imobilizim trupor që të jenë në gjendje për të lëvizur lirish, është rinovuar tualeti i një familjeje të rrezikuar në pikë-pamje sociale, është përgatitur një aplikim për personat që kanë të dëmtuar shqisën e të dëgjuarit që ta kenë më lehtë për të thirrur për ndihmë kur ata janë në situatë të rrezikshme për jetën, është siguruar një biçikletë dhome për një person që ka atrofi të plotë të muskujve, janë blerë inhalatorë për Repartin e fëmijëve në Spitalin shtetëror të Kërçovës dhe shumë e shumë gjëra të tjera. Për të gjitha projektet të rinjtë kanë investuar 28.555 orë vullnetare në komunitet dhe kanë mbledhur 24.630 euro, të cilat gjithashtu janë mbledhur nga komuniteti dhe janë kthyer tek i njëjti.

Në muajin maj janë mbajtur edhe dy punëtori finale, në të cilat kanë marrë pjesë 150 pjesëmarrës. Të rinjtë si çdo vit janë zgjedhur për cilësinë e projekteve të tyre, idenë origjinale, si dhe kohëzgjatjen e aksionit dhe efektin e realizimit të projektit. Gjatë punëtorisë finale janë thelluar njohuritë në lidhje me kulturën si sistem i vlerave dhe janë drejtuar të rinjtë për të vazhduar me aktivitetet e tyre në klubet e të rinjve në çdo OKKK.

Vitin e kaluar dy organizata komunale, Manastiri dhe Gostivari kanë fituar Kupën, për shkak se kanë punuar më së shumti projekte me diell, gjegjësisht projekte që bënë ndryshime të përhershme pozitive në komunitetin. Ngjarjet janë organizuar në Këshillin e qytetit në prani të një numri të madh të prindërve, mbështetësve, grupeve qëllimore, profesorëve dhe mediave lokale.

Vitin e 5-të me radhë është shënuar java KKA-PVH në periudhën nga 21 deri më 27 shtator. Edhe sivjet kjo javë është shënuar në mënyrë të unifikuar në territorin e gjithë vendit. Janë organizuar shfaqje teatrore me titullin "Historia e një ideje" që në të vërtetë është historia e Anri Dinanit dhe krijimi i Organizatës së Kryqit të kuq. Në përgatitjet në gjithë vendin janë përfshirë mbi 900 të rinj. Diku rreth 4.000 vizitorë kanë ardhur për të shikuar shfaqjet dhe për të nderuar punën e të rinjve në të gjitha OKKK-të. Qëllimi i javës KKA-PVH është promovimi i qëllimit të tretë strategjik i Strategjisë 2020 të KKR, promovimi i paqes, tolerancës dhe i mirëkuptimit të ndërsjellë.

VULLNETARIZMI NË

KRYQIN E KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Duke pasur parasysh natyrën e sfidave humanitare me të cilat u përball Republika e Maqedonisë në vitin 2016, një numër i madh i personave të moshave të ndryshme janë inkurajuar që të tregojnë interesim për t'u përfshirë në aktivitetet e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë. Format ekzistuese të punës me vullnetarë u dëshmuar të efektshme duke pasur parasysh se ndaj të gjitha situatave të jashtëzakonshme (kriza e migruesve, përmbytjet në rajonin e Shkupit dhe Tetovës, valët e ftohta dhe të nxehta etj.) është përgjigjur në mënyrë adekuate ndaj nevojave të popullsisë së prekur. Promovimi i punës së vullnetarëve në të gjitha mediat, si dhe mbështetja e iniciativave vullnetare nga ana e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë, në mënyrë plotësuese ka ngritur vetëdijen humane e cila rezultoi me vendosjen e partneriteteve dhe programeve të reja për veprim të përbashkët me organizatat në nivel lokal dhe nacional.

Mbështetja dhe zhvillimi i vullnetarizmit është një parakusht për të gjitha aktivitetet programore që i zbaton Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë. Prandaj angazhimi i vazhdueshëm për ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e suksesshëm të programeve vullnetare është një prioritet që zë një vend të përhershëm në aktivitetet e Shoqatës nacionale. Në vitin 2016 janë organizuar shumë trajnime për personat përgjegjës për organizimin e punës vullnetare, liderët e klubeve të të rinjve dhe përfaqësuesit e zgjedhur të organizatave komunale të Kryqit të kuq dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit, për të bërë vlerësimin, rekrutimin, organizimin, motivimin dhe koordinimin e suksesshëm të vullnetarëve në aktivitetet e Kryqit të kuq.

Më 5 dhjetor, "Dita Botërore e Vullnetarizmit", nga ana e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë në Muzeun e qytetit të Shkupit është organizuar një manifestim në të cilin janë ndarë fletë-falënderime për personat: Aleksandra Vasilevska, Rozhe Doan Van Haj, Kire Donovski, Edin Halim, Vlladimir Cvetkovski, Marjanço Angellkovski dhe Faik Alili për merita të veçanta në realizimin e qëllimeve dhe detyrave të Shoqatës nacionale dhe për aktivitetin e tyre shumëvjeçar si vullnetarë.



GATISHMËRIA DHE VEPRIMI GJATË KATASTROFA

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në vitin që e lamë pas me sukses u përball me një sërë sfidash në fushën e gatishmërisë dhe reagimit në katastrofa.

Uji i Bekuar 2016. Qendra për siguri në ujë dhe Ekipi për të reaguar në katastrofa i Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit më 19 janar ofroi një mbështetje të konsiderueshme në organizimin e manifestimit Uji i Bekuar 2016. Gjatë ngjarjes qendrore vullnetarët e shumtë (shpëtimtarët e ujit dhe të malit, logjistika dhe ndihma e parë, me një numër të përgjithshëm – 85 veta) janë kujdesur që ngjarja të kalojë në mënyrën më të mirë.



Punëtorja e Procedurave standarde operative. Në periudhën nga 13 deri më 15 prill, organizuar nga Sektori i Azilit në Departamentin e Punëve Civile, MPB-ja dhe Zyra e UNHCR-së në Shkup, në Hotelin Granit-Ohër, Kryqi i kuq i RM-së mori pjesë në punëtorinë për finalizimin e Procedurave standarde operative për trajtimin e kategorive të cënueshme të personave – të huaj.

Trajnimi i diseminimit për ARM-në. Në periudhën nga 4 deri më 13 maj të vitit 2016 me pjesëtarët e ARM-së në Shkup, Kumanovë, Tetovë dhe Veles, përfaqësuesit e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë kanë mbajtur ligjërata mbi diseminimin për Lëvizjen e Kryqit të kuq, si dhe vendi dhe roli i Kryqit të kuq i Republikës së Maqedonisë në gatishmërinë dhe veprimin në katastrofa. Grupi qëllimor i dëgjuesve kanë qenë oficerët dhe ushtarët profesionistë, të cilët me interesim kanë ndjekur ligjëratat dhe kanë shprehur kënaqësinë e bashkëpunimit.

Strategjia për ndryshimet klimatike të qytetit të Shkupit. Më 13 qershor në organizim të qytetit të Shkupit e në bashkëpunim me Programin e zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP), është zhvilluar punëtorja për propozim-versionin final të Strategjisë për ndryshimet klimatike të qytetit të Shkupit. Në këtë punëtori kanë marrë pjesë tre përfaqësues të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë.

Projekti “Gjenerata e ardhshme e Sistemit për menaxhimin e incidenteve në Republikën e Maqedonisë”. Më 3 nëntor të vitit 2016 në Qendrën për Menaxhimin e Krizave është mbajtur një takim pune në të cilin për disa nga subjektet e Sistemit për menaxhimin e krizave është bërë prezantimi i Projektit “Gjenerata e ardhshme e Sistemit për menaxhimin e incidenteve në Republikën e Maqedonisë”. QMK është bartëse e implementimit të këtij projekti që është zhvilluar nga ana e Institutit të Teknologjisë Laboratori Linkoln i Masaçusetsit (“Massachusetts Institute of Technology Lincoln Laboratory”) dhe sponsoruar nga Departamenti i Shkencave të Sigurisë Kombëtare dhe Drejtoria e Teknologjisë (“Department of Homeland Security Science and Technology Directorate”) të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Punëtorja për trajnues për “Menaxhimin dhe koordinimin e strehimoreve”. Në periudhën nga 17 deri më 19 tetor të vitit 2016 në Shkup është zhvilluar punëtorja për trajnues për “Menaxhimin dhe koordinimin e strehimoreve”, organizuar nga Organizata Ndërkombëtare për Migruesit (IOM), ndërsa pjesëmarrës kanë qenë të punësuarit në Qendrën për Menaxhimin e Krizave. Në pjesën praktike të trajnimit për ngritjen dhe menaxhimin e një vendbanimi-kamp janë përfshirë persona profesionalë të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë.

Punëtorja për vlerësimin e cënueshmërisë dhe kapaciteteve. Në periudhën nga 11 deri më 16.11.2016 në Strugë është zhvilluar punëtorja për vlerësimin e cënueshmërisë dhe kapaciteteve me 50 përfaqësues të organizatave komune të Kryqit të kuq dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit.




Promovimi i higjienës. Në periudhën 30.11 - 04.12.2016 në Strugë është zhvilluar punëtorja me 23 pjesëmarrës për Promovimin e higjienës në bashkëpunim me Kryqin e kuq të Austrisë, në kuadër të Apelit për mbështetjen e aktiviteteve të Shoqatës nacionale që janë duke u ndërmarrë për të ndihmuar migruesit.

Konceptet moderne të menaxhimit të krizave. Në periudhën nga 15 deri më 16.12.2016 në Ohër është mbajtur Konferenca Shkencore Ndërkombëtare me temën "Konceptet moderne të menaxhimit të krizave" e organizuar nga QMK dhe e mbështetur nga UNHCR, IOM, UNFAO.

Trajnimet dhe ligjëratat. Në planin e ngritjes së vetëdijes publike për zvogëlimin e pasojave të katastrofave në vitin 2016 në shkollën fillore "Shën Klimenti i Ohrit" është mbajtur ligjërata në temën "Mbrojtja dhe vetëmbrojtja në rast të katastrofave" dhe në SHF "Ismail Qemali" – Çair dhe SHF "Strasho Pinxhur" – f. Çeshinovë, në bashkëpunim me subjektet që janë pjesë e sistemit për menaxhimin e krizave janë organizuar ushtrime demonstruese taktike "Evakuimi dhe shpëtimi në katastrofa".



Shpëtimi në ujë. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në planin e sigurisë në ujë gjatë vitit 2016 ka mbajtur 6 kurse për trajnimin e shpëtimtarëve të ujit, nga të cilët 80 persona kanë marrë licencën shpëtimtar i ujit. Në fillim të sezonit të verës Qendra për siguri në ujë e Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit, në sipërfaqet ujore në territorin e qytetit të Shkupit ka punësuar 37 shpëtimtarë të ujit, ndërsa Qendra për siguri në ujë e OKKK e Ohrit, ka angazhuar 85 shpëtimtarë të ujit dhe 6 shpëtimtarë të ujit në bregun e liqenit në Strugë. Qendra për siguri në ujë e Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit ka dhënë mbështetje në organizimin e manifestimit Uji i Bekuar për vitin 2016.



MBËSHËTETJA HUMANITARE PËR POPULLSINË MIGRUESE

Aktivitetet për t'u përgjigjur ndaj nevojave humanitare të migruesve të cilët kalojnë transit përmes Republikës së Maqedonisë, si dhe mbështetja humanitare për ata që kanë mbetur në vend pas mbylljes formale të kufijve, ishte një nga aktivitetet kryesore të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë për vitin 2016. Ekipet e përbëra nga mjekë, paramedikë, logjistikë dhe vullnetarë, 24 orë kanë ofruar mbështetje për migruesit në kalimet kufitare në Gjevgjeli dhe Tabanoc. Përditë është ofruar ndihmë në mjete higjienike, ushqim, ujë të pijshëm, veshmbathje, ndihmë të parë, rivendosje të lidhjeve familjare, etj.

Për të kryer me sukses aktivitetet e lidhura me krizën migruese, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë, si pjesë e Sistemit për menaxhimin e krizave gjatë vitit 2016 mori pjesë në takimet e organizuara nga Qendra për Menaxhimin e Krizave, e cila ka rolin koordinues në ballafaqimin me krizën e migruesve dhe ka qenë në komunikim dhe koordinim të vazhdueshëm me subjektet e tjera dhe OJQ-të që janë përfshirë në krizën migruese.

Partnerët dhe donatorët kryesorë për gjithë operacionin ishin Komisioni i Lartë për Refugjatë (UNHCR), Federata ndërkombëtare e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, Komiteti ndërkombëtar i Kryqit të kuq (ICRC). Gjithsesi përveç tyre, si donatorë janë paraqitur edhe UNFPA, Fshati i Fëmijëve SOS, UNICEF-i, Kryqi i kuq i Gjermanisë, Karitas-i i Maqedonisë, Solidaritet, Save the children-Maqedoni dhe të tjerë.

Në qendrat në Tabanoc dhe Gjevgjeli kanë punuar ekipet për rivendosjen e lidhjeve familjare duke pasur mbështetjen e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të kuq. Në vitin 2016 janë regjistruar 464 raste të migruesve.

Ndihmat humanitare

Numrat kyç për vitin 2016

- Pako të shpërndara me ushqim 16.446;
- Pako të shpërndara me higjienë 12.446;
- Shishe të shpërndara me ujë 516.182 (0,5l);
- Ndihma e parë dhe asistimet e ofruara në të dyja qendrat e strehimit 83.928;
- Ndihma e parë dhe asistimet e ofruara në rajonin e Likovës 2.128;
- Janë regjistruar 464 raste.

Nga muaji prill i vitit 2016 në qendrat e strehimit të refugjatëve dhe migruesve – Vinojug dhe Tabanoc, janë duke u distribuuar shujta të ngrohta – ushqime të gatuar. Ushqimi ngrohet dhe shërbehet në një kuzhinë të ngritur posaçërisht. Aktiviteti është duke u

zbatuar në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale të RM-së dhe me mbështetjen e Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq.



Pasqyra e produkteve ushqimore të shpërndara në vitin 2016:

Produktet ushqimore	Sasia (copat)
Shujta të gatuar të ngrohta	80 485
Supë (pjata)	63 948
Çaj (gota)	90 513
Pako me ushqim (një vakt për 3 persona)	16 466
Qumësht çokollate	73 920
Biskota Plazma	26 725
Biskota energjetike	951
Ushqime të shëndetshme	9 525
Qumësht pluhur për foshnja	2 004
Lëng për fëmijë	6 867
Pasta për foshnja	4 931
Shishe për ushqimin e fëmijëve	3536

Përveç Kryqit të kuq ushqim dërgojnë edhe OJQ të tjera. Mbështetja për shpërndarjen e çajit dhe supave në Gjevgjeli ka ardhur nga Karitasi i Maqedonisë. Fshati i Fëmijëve SOS ka dhuruar ushqim për foshnjat, UNICEF-i ushqim për foshnjat dhe veshmbathje për fëmijët e moshës deri më 10 vjeç, dhe Save the children ka dhuruar qumësht. E gjithë shpërndarja e ushqimit është koordinuar nga Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë.

Pasqyra e produkteve higjienike të shpërndara në vitin 2016:

Produktet higjienike	Sasia (copa/paketime)
Paketa individuale higjienike	12 495
Facoleta të lagështa	39 339
Pelena për foshnja	44 753
Paketa për foshnja	1 264
Komplete të ndihmës së parë	77
Pudra për foshnja	4 602
Kremra për foshnja	8 771
Pluhur për larjen e rrobave	4 741
Peshqirë	8 702
Sprej kundër mushkonjave	122
Legenë për larjen e rrobave	862
Shampo për flokë	6052
Shtroja	675
Jastëk	327
Antiseptikë	2 616
Pudër për këmbë	1 480

Pasqyra e veshmbathjeve të shpërndara në vitin 2016:

Produktet	Sasia (copa)
Çorape (çift)	22 411
Triko grash	4 579
Fustane	798
Kanotiere	14 945
Veshje të brendshme	12 527
Veshje të brendshme për fëmijë	4 059
Kanotiere për fëmijë	847
Kapela verore	314
Atlete për fëmijë	1 271
Xhaketa të dimrit	12 475
Xhaketa verore për fëmijë	111
Pizhame	805
Çizme	9 992
Dukserë	356
Komplete për dimër (kapela, shalle dhe dorëza)	37 918
Kapela për fëmijë	804
Pantallona	1 434
Pantallona për fëmijë	152
Veshje për gra shtatzëna	14
Facoleta	41

Shpërndarjet shtesë në vitin 2016

Produktet	Sasia (copat)
Dyshekë	2 422
Batanije	31 528
Enë nate (oturakë)	2 192
Pardesy	2 192
Thasë gjumi (dyshekë për të fjetur)	3 622
Çanta	1992
Panele për ngrohje	12
Karroca për foshnja	26
Barelë për foshnja (kangur)	1 183
Mbulesa për fëmijë	161
Termose për ujë	24
Komplete për qepje	566
Cerada (pëlhura të gomuar)	1 301
Llamba dore	1 787



Migrimi jo i rregullt

Pas numrit të rritur të migruesve jo të rregullt që kalojnë transit përmes Republikës së Maqedonisë në periudhën nga muaji gusht deri në dhjetor të vitit 2016, gjithsej janë kryer 2128 asistime të ndihmës së parë ndaj migruesve jo të rregullt në rajonin e Gjevgjeliës, Llojanit, Likovës dhe Vaksincës nga ana e ekipit për mbështetje humanitare për këta persona.

Këtyre migruesve u janë dhënë produktet e mëposhtme:

Produktet	Sasia (copa)
Ujë 0,5 l.	13 946
Paketa me ushqim	2 401
Paketa për higjienë	269
Ushqim i gatshëm	171
Batanije	1 153
Thasë gjumi	212
Çanta shpine	185
Pardesy	880
Dyshekë	20
Çorape (çift)	2 297
Komplete dimri (kapelë, shall dhe dorëza)	717
Rroba	735
Llamba dore	58
Qumësht për foshnja	38
Biskota energjetike	320
Ushqim i shëndetshëm	856
Paketa për foshnja	29
Këpucë (çift)	520

Qendra transitore e migruesve

– Gazi Babë

Gjatë vitit 2016 është shpërndarë një sasi e madhe e produkteve në Qendrën transitore në Gazi Babë ku gjithashtu janë duke qëndruar migrues: ujë-shishe 6.110/ paketa me ushqim 600/ paketa për higjienë 700/ pajisje kuzhine 500/ prerëse thonjsh 240/ facoleta të lagështa 450/ antiseptikë 240/ brusha për flokë 360/ sapunë 960/ biskota çokollate 2600/ detergjent për larjen e rrobave 100/ batanije 120/ rroba – copa 1026/ ushqim i gatshëm 2174.

Trajnimet e zhvilluara për ngritjen e kapaciteteve të Shoqatës nacionale në kuadër të Apelit emergjent në vitin 2016:

- Ndihma e parë për punonjësit dhe vullnetarët e Kryqit të kuq
- Trajnimi i diseminatorëve për fushatën për ngritjen e vetëdijes për nevojat humanitare të migruesve “Stop indiferentizmit – Ta ruajmë humanitetin”
- Rivendosja e lidhjeve familjare
- Menaxhimi me vullnetarët
- Dhuna në baza seksuale dhe gjinore
- Sëmundjet e komunikueshme dhe jo të komunikueshme
- Proceset e realizimit të furnizimeve
- Vlerësimi i cënueshmërisë dhe kapaciteteve
- Promovimi i higjienës

PËRMBYTJET NË MUAJIN GUSHT TË VITIT 2016 NË RAJONIN E SHKUPIT DHE TETOVËS

Shirat e rrëmbyeshëm që më 6 gusht të vitit të kaluar kapluan rajonin e Shkupit dhe Tetovës, shkaktoan përmbytje të cilat për fat të keq rezultuan me 22 viktima dhe me mbi 60 persona të lënduar, dhe me një dëm të madh material. Fshatrat dhe vendbanimet më të prekura nga përmbytjet ishin: Çentoja, Inxhikova, Hasanbegu, Stajkovca, Smillkovca, Cresheva, Viniçe, Straçinca në rajonin e Shkupit dhe fshatrat Shipkovica, Brodeci, Veshalla dhe Poroji në rajonin e Tetovës. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë sipas planeve të veprimtimit, nga fillimi i katastrofës ishte në komunikim dhe koordinim të vazhdueshëm me organet e shtetit. Sekretari i përgjithshëm i Kryqit të kuq si pjesë e shtabit të krizës mori pjesë në takimet e Qeverisë ku merreshin vendimet për ndërmarrjen e masave konkrete për të ndihmuar popullsinë e prekur.

Kryqi i kuq i RM-së nga rezervat e veta ofroi ndihma humanitare për popullsinë e prekur përmes shpërndarjes së batanijeve, dyshekë, mjete për higjienë dhe ujë të pijshëm për 1000 persona. Një pjesë e popullsisë së prekur u akomodua në familjet dhe qendrat ku Kryqi i kuq ofroi ndihma humanitare. Për popullsinë e prekur sipas nevojave të tyre Kryqi i kuq shpërndau ndihmë përkatëse humanitare. Në tërë operacionin u përfshinë 150 vullnetarë dhe profesionistë të ndarë në 7 ekipe lëvizëse.

Nga 8 gushti i vitit 2016 Kryqi i kuq i RM-së nga ana e Qeverisë u caktua për të koordinuar shpërndarjen e ndihmave humanitare për popullsinë e rajoneve të

përmbytura. Për t'u përballur me pasojat e përmbytjeve Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë aktivitetet i ka zbatuar në komunikim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me Zyrën Rajonale për Evropën të Federatës Ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe (IFRC).

Në periudhën nga 08-31 gusht të vitit 2016 është bërë implementimi i fushatës së grumbullimit të mjeteve përmes së cilës të gjitha subjektet e interesuar fizikë dhe juridikë mund të përfshiheshin dhe të dhuronin mjete për të mbështetur të përmbyturit. Fushata mundësoi dhurimin e fondeve përmes llogarisë bankare të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë në "Fondin e solidaritetit" dhe duke bërë thirrje në operatorët celularë në numrin 070/075/077 143 400 në mënyrë që për çdo thirrje janë dhuruar nga 100 denarë. Fushata pati jehonë të gjerë në publik, janë mbledhur gjithsej 68.406.667 denarë, janë bërë transfertat të drejtpërdrejta të parave të gatshme për 4.463 familje nga 13.285,00 denarë. Në mesin e dhuruesve do të përmendim kompaninë NOVARTIS e cila ka ofruar donacion në shumë prej 82.000 eurove.

Nga ana e Kryqit të kuq të RM-së është hartuar DREF dhe ai është miratuar nga Federata ndërkombëtare e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe në shumë prej 310,228 CHF. Në këtë operacion janë shpërndarë 4600 paketa familjare me ushqim (për 2 muaj) për 2300 familje, 2300 paketa familjare për higjienë dhe 300 paketa për foshnje.

Në periudhën 12.08.2016-12.08.2017 me mbështetjen e Agjencisë së Zhvillimit të Austrisë dhe Kryqit të kuq të Austrisë është duke u zbatuar Projekti "Rimëkëmbja dhe qëndrueshmëria e hershme" që ka për qëllim të ndihmojë financiarisht 320 familje (me



transferta të parave të gatshme në vlerë prej 1000 euro), të cilat nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale janë identifikuar si raste më të rrezikuara sociale në rajonin e prekur nga përmbytjet. Përveç mbështetjes financiare për këto 320 familje, në kuadër të 6 shkollave fillore janë paraparë një numër i madh aktivitetesh dhe punëtorish me nxënës, arsimtarë dhe prindër, dhe në mënyrë shtesë janë siguruar çanta shpine dhe pajisje shkollore për 600 nxënës. Vlera e përgjithshme e Projektit është 475 424 euro.

Ambasada e Polonisë dhuroi mjete në lartësi prej 1.072.148 denarë, me të cilat janë furnizuar paketa higjienike dhe paketa me ushqim. Nga Gjysmëhëna e kuqe e Turqisë është marrë donacion me vlerë të përgjithshme prej 9.370 euro.

Përveç mbështetjes së grupeve qëllimore, në periudhën nga 13 deri më 15.12.2016 në Strugë në kuadër të Operacionit DREF për përmbytjet, është mbajtur trajnim për logjistikë dhe shpërndarje të ndihmave humanitare për ngritjen e kapaciteteve të vullnetarëve dhe shërbimit profesional të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë për trajtim më efikas të situatave të ardhshme dhe një trajnim për leksionet e mësuara përmes së cilit u panë anët e mira të gjithë operacionit dhe gjërat që në të ardhmen mund të përmirësohen.



Kujdesi dhe mbështetja për personat e moshuar

Kryqi i kuq i RM-së gjatë vitit 2016 vazhdoi me zbatimin e Projektit “Kujdesi për personat e moshuar në kushte shtëpiake” i mbështetur nga Kryqi i kuq i Austrisë, EVN-ja e Maqedonisë dhe Fondacioni Albiz. Aktivitetet e projektit janë realizuar nga Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit dhe organizatat komunale të Kryqit të kuq Veles, Kriva Pallankë, Kërçovë, Dibër dhe Strugë. Janë angazhuar gjithsej 64 vullnetarë të Kryqit të kuq dhe 13 infermiere të cilët në vazhdimësi kanë dhënë shërbime sociale dhe shëndetësore për gjithsej 402 persona të moshuar në kushte shtëpiake.

Më 10 maj është organizuar punëtorja për shkëmbimin e përvojave të ekipeve të projektit të vullnetarëve dhe infermiereve të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit dhe organizatat komunale të Kryqit të kuq të Kriva Pallankës dhe Velesit, në kuadër të aktiviteteve të mbështetura nga Kryqi i kuq i Austrisë.

Nga 26 deri më 28 gusht të vitit 2016 në kuadër të Projektit të mbështetur nga Kryqi i kuq i Austrisë, Kryqi i kuq i RM-së në bashkëpunim me Entin për veprimtari sociale ka organizuar një punëtori për trajnimin e 15 vullnetarëve të rinj të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit dhe organizatat komunale të Kryqit të kuq Veles dhe Kriva Pallankë për t’u përfshirë në intervenimin social me persona të moshuar. Qëllimi i punëtorisë ishte që vullnetarët e Kryqit të kuq të marrin njohuri dhe shkathtësi themelore për të ofruar mbështetje për personat e moshuar në kushte shtëpiake. Në kuadër të projektit të mbështetur nga Kryqi i kuq i Austrisë janë realizuar edhe gjashtë iniciativa të vogla në temën “Plakja aktive” të cilat janë zbatuar nga Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit dhe organizatat komunale të Kryqit të kuq Veles dhe Kriva Pallankë.

Përmes Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit kanë vazhduar të zbatohen në vazhdimësi aktivitetet programore për të moshuarit në qendrat ditore për personat e moshuar dhe qendrat për dhënien e ndihmës në kushte shtëpiake me lokale në SHOH “Dare Xhambaz” dhe në Organizatën komunale të Kryqit të kuq të Çairit, si dhe në lokalet e SHF në Komunën e Sarajit. Gjithashtu aktivitetet që janë organizuar përmes Qendrës ditore në Gazi Babë janë zbatuar në vazhdimësi edhe gjatë vitit.

Nëpërmjet klubeve të personave të moshuar që funksionojnë përmes organizatave komunale të Kryqit të kuq Kriva Pallankë, Negotinë, Veles dhe Prilep, gjatë gjithë vitit ka vazhduar zbatimi i aktiviteteve përkatëse për dhe me personat e moshuar.



Përmirësimi i aftësisë konkurruese në tregun e punës

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në partneritet me Odën e zejtarëve të Shkupit në periudhën nga muaji dhjetor i vitit 2015 deri më gusht të vitit 2017, me mbështetje financiare të Bashkimit Evropian është duke zbatuar Projektin “Ndërmerr aksion për një aftësi konkurruese më të mirë në tregun e punës”. Qëllimi i këtij projekti është që të avancohen kushtet dhe mundësitë për punësimin e personave në rrezik social të papunë afatgjatë të komunave: Gazi Babë, Kisella Vodë dhe Gjoççe Petrov, i cili u realizua përmes Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit. Në fillim të Projektit u përzgjedhën 40 përfitues – persona në rrezik social të papunë afatgjatë nga të tria komunat.

Për të qenë të informuar dhe për t’i mësuar qëllimet dhe aktivitetet e projektit është mbajtur një takim me përdoruesit dhe nga ana e tyre është nënshkruar një deklaratë se ata janë dakord për t’u përfshirë në projektin. Për të përforcuar kapacitetet e tyre në drejtim të avancimit të shkathtësive sociale të rritjes dhe zhvillimit personal janë zhvilluar punëtori me përdoruesit. Janë përgatitur plane individuale të aksionit për përdoruesit me qëllim që të bëhen më të vetëdijshëm për

pjesëmarrjen e tyre aktive në projektin. Gjatë gjithë periudhës nga ana e ekipit lokal të projektit me 4 punonjës sociale dhe një psikolog është mundësuar mbështetja psiko-sociale për familjet me qëllim të mbështetjes dhe lehtësimit të procesit të marrjes së trajnimeve. Për të mundësuar përforcimin e kapaciteteve të përdoruesve për rritjen dhe zhvillimin personal, si dhe rritjen e motivimit personal, në vazhdimësi është zbatuar psikoterapia grupore dhe individuale geshtalt. Janë zhvilluar punëtori për verifikimin e pritjeve, vlerave, motiveve dhe nevojave të përdoruesve, vizita të zanateve dhe një punëtori për verifikimin e zanateve. Janë realizuar kontrole sanitare dhe mjekësore për përdoruesit.

Më 5 dhjetor është mbajtur një takim në mes të një këshilltari të përfshirjes sociale të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale dhe ekipit të projektit me qëllim të informimit për aktivitetet e projektit dhe mbështetjes në zbatimin e projektit.

Nga 28 nëntori i vitit 2016 ka filluar zbatimi i trajnimeve të zanateve për 38 përdorues të projektit që do të zgjasin nga 3 deri në 6 muaj varësisht nga programi i trajnimit për zanate. Këto janë zanatet që do të mësohen nga përdoruesit: floktar, mjeshtër kozmetike për mirëmbajtjen e fytyrës dhe trupit, mjeshtër makijazhi dhe manikyri, ëmbëltor, mjeshtër picash, mjeshtër byreku dhe i produkteve të furrës, bukëpjekës, dekorimi i ngjarjeve dhe rregullimi i enterierëve, fotograf, qëndisje dhe thurje dore, rrobaqepësi, argjendar, bravandreqës, çelësabërës dhe zdrukthëtar.

Nga mbështetja teknike për menaxhimin dhe monitorimin e projekteve të programit të grantit "Nxitja e përfshirjes sociale" gjatë vitit janë organizuar punëtori të cilat janë dedikuar për trajnimin e përfaqësuesve të organizatave të qytetarëve që bëjnë implementimin e projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian në kuadër të këtij programi të grantit. Ekipi i projektit i Kryqit të kuq të RM-së ndoqi trajnimet që synonin për të forcuar shkathtësitë dhe për të rritur njohuritë e grantistëve për zbatimin e efikas dhe etik të grantit. Gjatë vitit lideri i ekipit dhe një përfaqësues i projektit për ndihmë teknike që kanë bërë një vizitë monitoruese, kanë shprehur kënaqësinë për implementimin e aktiviteteve të projektit dhe kanë dhënë sugjerime për zbatimin e mëtejshëm të suksesshëm të aktiviteteve.



Projekti "Përmirësimi i socializimit të fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të veçanta"

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në kuadër të projektit: "Përmirësimi i socializimit të fëmijëve dhe i të rinjve me nevoja të veçanta", me mbështetjen e marrë nga Banka Komerciale SHA Shkup dhe në bashkëpunim me Entin për veprimtarinë sociale, gjatë muajit shtator përmes Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit dhe organizatat komunale të Kryqit të kuq Prilep, Kavadar, Gostivar, Veles, Dellçevë, Dibër dhe Kërçovë, ka organizuar aktivitete në bashkëpunim me qendrat ditore për fëmijët me nevoja të veçanta dhe qendrat e punës sociale, si dhe me përfaqësues të filialeve të Bankës Komerciale.

Nga 18 deri më 20 mars të vitit 2016 Kryqi i kuq ka organizuar një punëtori arsimore që është zhvilluar në Qendrën "Solferino" në Strugë. Qëllimi i punëtorisë ishte arsimimi i vullnetarëve të rinj të Kryqit të kuq për t'u pajisur me njohuri dhe shkathtësi të caktuara për qasje dhe mbështetje të fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të veçanta.

Sipas planeve të përgatitura të veprimit, gjatë vitit janë zbatuar këto aktivitete: vizita në shtëpitë e familjeve kujdestare në Shkup, Prilep dhe Veles nga ana e ekipeve lëvizëse të vullnetarëve të Kryqit të kuq për të siguruar mbështetje për fëmijët, në qendrat ditore me përfshirjen e vullnetarëve të Kryqit të kuq janë organizuar punëtori kreative, aktivitete arsimore, rekreative, si dhe shumë aktivitete të tjera për përmirësimin e socializimit të fëmijëve.

Më 15 dhjetor të vitit 2016, Kryqi i kuq i RM-së

ka zhvilluar punëtori për vlerësimin e aktiviteteve të projektit. Qëllimi i punëtorisë ishte përcaktimi i rezultateve të arritura, efektet e aktiviteteve të zbatuara, si dhe dhënia e udhëzimeve për veprim të ardhshëm në nivel lokal.

Bashkëpunimi rajonal për përfshirje sociale të personave të moshuar

Nga muaji shkurt i vitit 2016 filloi implementimi i projektit rajonal “Ndërmarrja e aktiviteteve për përfshirjen sociale të personave të moshuar” i financuar nga Bashkimi Evropian që do të zbatohet në periudhë prej tre vjetësh nga Kryqi i kuq i Serbisë si koordinator i projektit në partneritet me Kryqin e kuq të Austrisë, Kryqin e kuq të Maqedonisë, Shoqatën qytetare “Humanost” nga Maqedonia, Kryqin e kuq të Malit të Zi dhe me shoqatat qytetare të Shqipërisë dhe Bosnjë e Hercegovinës. Qëllimi i projektit është krijimi i rrjetave rajonale të shoqatave qytetare dhe organizatave të Kryqit të kuq në pesë vende të Ballkanit Perëndimor, që do të bëjnë implementimin e aktiviteteve për të rritur vetëdijen publike dhe për të pasur ndikime të mëvonshme në proceset e marrjes së vendimeve lidhur me përfshirjen sociale të personave të moshuar.

Më 13 prill të vitit 2016 Kryqi i kuq i RM-së në partneritet të përbashkët me “Humanost” ka organizuar një takim inicial në të cilin janë prezantuar aktivitetet e projektit që do të zbatohen në Maqedoni në periudhë prej tre vjetësh. Më 26 prill është mbajtur takim me përfaqësuesin e delegacionit të Bashkimit Evropian në Bruksel në të cilin janë prezantuar përvojat e deritashme nga aktivitetet e zbatuara për personat e moshuar në Maqedoni, si dhe informacionet për aktivitetet e realizuara në kuadër të projektit rajonal.

Në takimin nacional të rrjetit të organizatave qytetare për përfshirjen sociale të personave të moshuar, në të cilin u nënshkrua vendimi për funksionimin zyrtar të rrjetit joformal – InkluzivaM, është përgatitur edhe plani strategjik i punës së rrjetit për periudhën prej tre vjetësh, mbi bazë të analizës së situatës së përgatitur në Maqedoni, e cila ka përfshirë informacionet për palët e interesuara relevante, mungesat në politikat, shërbimet dhe nevojat e personave të moshuar, si dhe kapacitetet e sektorit civil për zbatimin e aktiviteteve të përfaqësimit të iniciativave për përfshirjen sociale të personave të moshuar.

Nga 26 deri më 30 shtator është realizuar një vizitë studimore në Slloveni për aktivitetet për personat e moshuar, organizuar në kuadër të projektit rajonal. Kanë marrë pjesë përfaqësues të ekipeve të projektit dhe përfaqësues të shoqatave qytetare – anëtare të rrjetit për përfshirjen sociale të personave të moshuar, si dhe përfaqësues të institucioneve qeveritare. Enti për veprimtari sociale është një bashkëpunëtor



i përfshirë në projektin dhe një përfaqësues i tyre ka marrë pjesë në këtë vizitë duke paraqitur në diskutimin e panelit situatën dhe masat e ndërmarra nga ana e shtetit për përmirësimin e cilësisë së jetës së personave të moshuar.

Për nevojat e rrjetit InkluzivaM në muajin shtator është organizuar punëtorja për përfaqësim, me qëllim të përforsimit të kapaciteteve të anëtareve të rrjetit dhe përcaktimin e fushave të prioritetit lidhur me trajtimin e çështjes së plakjes. Si prioritet është theksuar nevoja e hapjes së shërbimeve sociale dhe shëndetësore për të moshuarit. Në periudhën e ardhshme do të përgatitet një hulumtim mbi këtë çështje në mënyrë që të sigurohen prova për të ndikuar në marrjen e vendimeve në institucionet qeveritare për nevojën dhe zhvillimin e shërbimeve për të moshuarit.



Punëtoritë me anëtarët e InkluzivaM në bashkëpunim me UNFPA

Më 13 dhe 31 tetor të vitit 2016 në organizim të “Humanost”-it dhe në bashkëpunim me Kryqin e kuq të RM-së dhe UNFPA, janë zhvilluar punëtoritë me anëtarët e rrjetit InkluzivaM për përgatitjen e raporteve katërvjeçare për implementimin e aktiviteteve për të moshuarit. Maqedonia është një nga vendet e rajonit që ka miratuar Deklaratën e Vjenës për “Ofrimin e një shoqërie për të gjitha moshat: Promovimi i cilësisë së jetës dhe plakja aktive”.

Kjo deklaratë është miratuar në Konferencën e tretë ministrore për plakjen të UNECE (Vjenë, viti 2012), me rastin e rishikimit dhe vlerësimit të dytë të implementimit të Planit ndërkombëtar të aksionit të Madridit për plakjen, 2002 (MIPAA) dhe Strategjia e saj rajonale për implementimin në rajonin e UNECE (RIS). Të gjithë faktorët, si: ministrinë, pushtetet rajonale dhe lokale, organizatat joqeveritare (OJQ), sektori privat, partnerët socialë, institucionet dhe organizatat akademike që përfaqësojnë interesat e të moshuarve dhe të rinjve – në kontekstin midis brezave – duhet të paraqesin raportet mbi aktivitetet e tyre lidhur me implementimin e Deklaratës së Vjenës dhe të përcaktojnë planet për veprim të mëtejshëm, si dhe zonat kryesore me masa specifike.

“Kontributi juaj – një ndihmë e rëndësishme”

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë me moton: “Kontributi juaj – një ndihmë e rëndësishme” nga 18 deri më 24 prill të vitit 2016 me aktivitete përkatëse ka shënuar Javën tradicionale të solidaritetit. Në kuadër të Javës, Kryqi i kuq ka organizuar Aksion grumbullimi për të zgjuar ndjenjën e humanitetit, reciprocitetit dhe solidaritetit tek qytetarët, veçanërisht tek brezi i ri për ndihmën dhe mbështetjen e ndërsjellë, si dhe për të ofruar ndihmë përkatëse për kategoritë më të rrezikuara të popullsisë. Në këtë aksion mund të dhurohej ushqim, veshmbathje, mjete të higjienës, si dhe mjete në të holla duke bërë thirrje në tre numrat e telefonit celular, si dhe duke paguar donacione në llogarinë e Fondit të solidaritetit të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë. Në kuadër të kësaj jave është organizuar edhe aksioni “Shtëpi më shtëpi” në të cilin vullnetarë të organizatës komunale të Kryqit të kuq vizituan qytetarët në shtëpitë e tyre, të cilët dhanë mjete sipas dëshirës dhe mundësive të tyre. Mjetet në të holla të grumbulluara nga aksioni ishin të dedikuara për sigurimin e ndihmës në ushqim për familjet në rrezik social.



U shënua 1 tetori – Dita ndërkombëtare e të moshuarve

Kryqi i kuq i RM-së çdo vit përfshihet në shënimin e 1 Tetorit – Ditës ndërkombëtare të personave të moshuar. Me rastin e kësaj dite përmes organizatave komunale të Kryqit të kuq janë zbatuar aktivitetet për nxitjen e plakjes aktive: edukuese, punëtori kreative, aktivitete rekreative etj, pastaj aktivitetet për mbështetjen e të moshuarve siç janë të vizituarit e të moshuarve nëpër shtëpitë e tyre, të vizituarit e të moshuarve në mjedise rurale etj.

Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit ka organizuar një takim me partnerët lokalë në temën “Sfidat e ardhshme të qytetit të Shkupit për të punuar me personat në moshën e tretë” në të cilin morën pjesë përfaqësues të institucioneve qeveritare lokale, sektori civil dhe privat dhe persona të moshës së tretë që vizitojnë Qendrën ditore për persona të moshuar. Gjithashtu është organizuar edhe Seminari Çi Kong për personat e moshuar aktivë. Janë bërë vizita për personat e moshuar dhe të dobët në shtëpitë e tyre, të cilat nga vullnetarët dhe infermieret e Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit dhe organizatat komunale të Kryqit të kuq Veles, Kriva Pallankë, Kërçovë, Strugë dhe Dibër, janë kryer rregullisht.

Fushata e Ditës së urisë

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë çdo vit shënon 16 tetorin – Ditën e urisë, duke organizuar fushatën me moton “Mendoni edhe për ne”. Me këtë fushatë dhe me shumë aktivitete të tjera humanitare, Kryqi i kuq i RM-së jep kontribut në përpjekjet e përgjithshme që ndërmerren në vend për të ulur varfërinë dhe përjashtimin social të qytetarëve, si një nga qëllimet kryesore të strategjisë, dokument ky që pasqyron synimin e Republikës së Maqedonisë për barazimin e nivelit të përfshirjes dhe mirëqenies në të gjitha shtresat e shoqërisë.

Në kuadër të fushatës janë organizuar aksione humanitare për sigurimin e donacioneve në të holla dhe ushqim, në bashkëpunim me institucionet arsimore-edukuese, shoqatat qytetare, odat ekonomike në Maqedoni dhe në bashkëpunim dhe mbështetje të kompanive dhe qytetarëve. Këto aktivitete janë zbatuar gjatë Javës nga 16 deri më 22 tetor të vitit 2016 nga organizatat komunale të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit. Mjetet e dhuruara në aksionin humanitar ishin të destinuara për sigurimin e ushqimit dhe për të ndihmuar popullsinë e rrezikuar dhe shpërndarja e tyre do të bëhet nga organizatat komunale të Kryqit të kuq.



Java e kujdesit për të moshuarit

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë sivjet “Javën e kujdesit për të moshuarit” që është tradicionale e shënoi nga 21 deri më 28 nëntor me moton “Të gjithë ne jemi fëmijët e tyre”. Qëllimi i shënimit të Javës është ngritja e vetëdijes së popullsisë për të drejtat e të moshuarve, si dhe për kujdesin dhe ndihmën e nevojshme për të moshuarit.

Në kuadër të Javës është organizuar një aksion i matjes falas të sheqerit në gjak dhe tensionit të gjakut për 2000 të moshuar, për të cilën mbështetje ofroi EVN-ja e Maqedonisë. Nga organizatat komunale të Kryqit të kuq dhe Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit me rastin e Javës janë organizuar aktivitete humanitare (punëtori arsimore, kreative me personat e moshuar, vizita të personave të moshuar në shtëpitë e tyre, kontrolle falas, vizita në shtëpitë e pleqve, në shtëpitë e pensionistëve etj.).

Aktivitetet në nivel lokal janë zbatuar në bashkëpunim me shoqatat komunale të pensionistëve me të cilët Kryqi i kuq i RM-së në vazhdimësi realizon bashkëpunim të mirë, si dhe me qendrat e punës sociale dhe shoqatat qytetare. Për promovimin e aktiviteteve me mbështetjen e Kryqit të kuq të Austrisë është përgatitur një TV-spot me përmbajtje përkatëse për ngritjen e vetëdijes publike për kujdesin dhe mbështetjen e nevojshme për të moshuarit.

Është shënuar Dita e Evropës dhe Java e luftës kundër tregtisë me njerëz

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë si anëtar i Sekretariatit të Komisionit Nacional për luftë kundër tregtisë me njerëz dhe emigrim ilegal jep kontribut aktiv në luftën kundër tregtisë me njerëz – që është një problem global dhe reflektohet edhe në Maqedoni.

Në këtë drejtim Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë është përfshirë në shënimin e 18 tetorit – Ditës evropiane të luftës kundër tregtisë me njerëz, dhe nga 2 deri më 9 dhjetor – Javës së luftës kundër tregtisë me njerëz. Me rastin e Ditës dhe Javës janë organizuar aktivitete preventive nga Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit dhe organizatat komunale të Kryqit të kuq Gazi Babë, Kavadar, Manastir, Veles, Ohr, Berovë, Vallandovë, Radovish, Kumanovë, Kërçovë, Koçanë, Kruševë dhe Sveti Nikollë. Në nivel lokal janë mbajtur gjithsej 27 punëtori për arsimim me bashkëmoshtarë për të rinj në shkolla fillore dhe të mesme. Me aktivitetet preventive janë përfshirë mbi 675 nxënës. Leksionet preventive kanë për qëllim ngritjen e vetëdijes së të rinjve, njohjen e mënyrave përmes së cilave të rinjtë mund të jenë përfshirë në tregtinë me njerëz dhe vetëmbrojtja e tyre.

Pushim dhe rekreacion për fëmijët e familjeve në rrezik social dhe fëmijët shfrytëzues të shtesës speciale

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale gjatë periudhës dimërore në muajin janar të vitit 2016 ka organizuar një pushim dhe rekreacion falas për fëmijët e familjeve në rrezik social, fëmijët shfrytëzues të shtesës speciale dhe të drejta të tjera, në pushimoren “Begova Korja” në Kruševë. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë është përfshirë në këtë aktivitetet të projektit duke angazhuar vullnetarë të Kryqit të kuq në rolin e edukatorëve për të argëtuar fëmijët gjatë qëndrimit të tyre. Vullnetarët kanë përgatitur programe me aktivitete edukative, rekreative dhe kreative të cilat i kanë zbatuar së bashku me fëmijët gjatë qëndrimit të tyre në Kruševë.

Ky projekt është zbatuar edhe gjatë periudhës së verës në muajt korrik dhe gusht të vitit 2016. Vullnetarët e angazhuar – edukatorë/bashkëpunëtorë profesionalë dhe shpëtimtarë të ujit të Kryqit të kuq i kanë shoqëruar fëmijët dhe kanë realizuar aktivitete me fëmijët në pushimoren për fëmijë “Majski cvet” – Strugë.



Aksioni humanitar “Të ndajmë gëzimin”

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në bashkëpunim dhe me mbështetjen e EVN të Maqedonisë për herë të gjashtë ka organizuar aksion të përbashkët humanitar “Të ndajmë gëzimin”. Në kuadër të aksionit janë siguruar 320 paketa të Vitit të Ri për fëmijët e familjeve në rrezik social dhe fëmijët me nevoja të veçanta. Dhuratat janë ndarë nga Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit dhe organizatat komunale të Kryqit të kuq Koçanë, Kërçovë, Strugë, Shtip, Gjevgjeli, Manastir dhe Strumicë, në bashkëpunim me përfaqësues të EVN-së në komunat në të cilat është realizuar aksioni. Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit më 28 dhjetor të vitit 2016 në ambientet e Kinotekës së Maqedonisë ka organizuar një ngjarje të përbashkët të Vitit të Ri për 130 fëmijë me nevoja të veçanta, fëmijë me probleme arsimore sociale dhe fëmijë të familjeve të kategorive të rrezikuara. Fëmijët ndoqën një projektim kinemaje të një filmi të animuar 3D që u mundësua nga Megakom.

VEPRIMTARIA PREVENTIVE-SHËNDETËSORE

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë sipas Planit strategjik 2020 dhe Programit preventiv shëndetësor për vitin 2016, gjatë vitit 2016 ka zbatuar aktivitete në terren për parandalimin, ruajtjen dhe përmirësimin e gjendjes shëndetësore të grupeve më të rrezikuara të popullsisë. Gjatë këtij viti janë realizuar një numër i madh i aktiviteteve të cilët ishin drejtuar drejt parandalimit të transmisionit të HIV-it në mesin e grupeve më të rrezikuara të popullsisë, përmirësimin e kontrollit me tuberkulozin në nivel lokal përmes ngritjes së vetëdijes dhe njohurive për këtë sëmundje, kujdesit shëndetësor për personat e moshuar dhe të dobët, si dhe zvogëlimin e pasojave shëndetësore që janë rezultat i ndryshimeve klimatike, parandalimin e sëmundjeve infektuese dhe jo-infektuese, ngritjen e vetëdijes për dhurimin e organeve dhe një sërë aktiviteteve të tjera.

Zvogëlimi i dëmeve nga përdorimi i drogës

Zvogëlimi i dëmeve nga përdorimi i drogës – është një projekt i dedikuar për personat – përdorues të drogës dhe është zhvilluar në territorin e tri organizatave komunale të KK Kërçovë, Veles dhe Prilep. Qendrat e hapura në organizatat komunale kishin për qëllim ofrimin e shërbimeve mjekësore, sociale dhe juridike, si dhe për të furnizuar të njëjtat me prezervativë dhe pajisje sterile për injektim, material edukativ informativ.

Qëllimi i projektit ishte zvogëlimi i dëmeve nga përdorimi i drogës, në drejtim të përmirësimit të statusit shëndetësor, social dhe ekonomik të përdoruesve. Përdoruesit e drogës kanë mundësi për të marrë pajisje sterile për injektim, si dhe këshillime rreth dëmeve të mundshme të shkaktuara nga përdorimi i pajisjes jo të sterilizuar, siç janë HIV/SIDA dhe hepatiti B dhe C.

Në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik dhe OJQ HERA është zhvilluar edhe këshillimi i besueshëm dhe testimi në terren në Prilep dhe Veles.

Përmes realizimit të punësorive kreative që kishin për qëllim risocializimin e klientëve, këta të fundit patën mundësinë për të shprehur talentin e tyre përmes vizatimit, përpunimit të stolive dhe gjësëndeve të ndryshme nga argjila, letra etj.

Me këtë projekt gjatë vitit 2016 janë përfshirë 448 persona të popullsisë së përdoruesve, janë realizuar 3120 kontakte me personat e grupit qëllimor. Për nevojat e përdoruesve janë ndarë: 46 672 gjilpëra, 30 700 shiringa, 22 676 prezervativë, janë realizuar 265 shërbime juridike, 3110 shërbime të ndryshme dhe 4708 shërbime mjekësore.

Zbatimi i arsimimit për tuberkulozin për grupe të ndryshme qëllimore

Për të ngritur vetëdijen publike tek popullsia për parandalimin e tuberkulozit si sëmundje infektuese, njohjen e hershme dhe zbulimin e tij në kohë, mundësitë e mjekimit, Kryqi i kuq i R. së Maqedonisë edhe gjatë vitit 2016 ka realizuar arsimim për grupe të ndryshme qëllimore që janë në rrezik për të marrë këtë sëmundje, si popullsia rome, popullsia në mjediset ru-



rale, me status të ulët social etj.

Arsimimi është realizuar në shumë organizata komunale të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë, si: Kërçovë, Krushevë, Kavadar, Prilep, Koçanë, Strumicë dhe janë përfshirë gjithsej 8 714 përfaqësues të grupeve qëllimore.

Ndryshimet klimatike – mbrojtja e shëndetit nga ndryshimet klimatike (valët e nxehta, të ftohta)

Aktivitetet sipas planit të aksionit për kohën e ngrohtë filluan gjatë muajit maj me qëllim përgatitjen dhe shpërndarjen e materialit arsimor informativ për grupe të ndryshme qëllimore lidhur me mbrojtjen nga valët e nxehta përmes organizatave komunale të Kryqit të kuq në territorin e gjithë vendit dhe Qendrat e Shëndetit Publik. Në periudhën nga 15 qershori deri më 15 shtator ka funksionuar linja SOS për valë të nxehta në kuadër të KK të Qytetit të Shkupit për të dhënë këshilla falas lidhur me mbrojtjen e shëndetit nga valët e nxehta.

Gjatë valëve të nxehta, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë përmes organizatave komunale ka ndërmarrë aktivitete në drejtim të sigurimit të ujit pa gaz në shishe që u është ofruar qytetarëve, materiale arsimore informative me këshilla për mbrojtjen e shëndetit nga valët e nxehta, matje falas të tensionit të gjakut për qytetarët që kishin nevojë për këtë, si dhe sigurimin e ndihmës së parë në rast të një nevoje eventuale për të.

Në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik dhe sipas planit të aksionit për kohën e ftohtë gjatë muajit janar të vitit 2016 janë shpërndarë flajerë për kohën e ftohtë dedikuar për grupe të ndryshme qëllimore: për popullsinë e përgjithshme, mjekët amë dhe punonjësit/punëdhënësit, me këshilla dhe rekomandime preventive si të mbrojnë shëndetin e tyre në kushte të motit të ftohtë.

Në këtë drejtim me mbështetjen financiare të KK të Gjermanisë është përgatitur një broshurë me informacione për mbrojtjen e shëndetit të migruesve gjatë motit të ftohtë në mënyrë të skajshme, në gjuhën arabe.

Gjatë temperaturave të ulëta strehimorja në kuadër të Stacionit për të pastrehët në Momin Potok ka qenë e hapur 24 orë. Ekipe të lëvizëse të Kryqit të kuq që ishin në dispozicion 24 orë, me të marrë një thirrje kanë dalë në terren dhe u kanë ofruar të pastrehëve qëndrim në strehimoren. Gjithsej 28 persona janë akomoduar në strehimoren dhe kanë marrë shërbimet që janë ofruar në stacion (mirëmbajtje e higjienës personale, veshmbathje e pastër, shërbime floktarie, kontrolle mjekësore, shujta të ngrohta dhe shtrat i ngrohtë)

Nga 4 - 17 shkurt të vitit 2016 është hapur një pikë e përkohshme për të shpërndarë çaj, supë, batanije dhe thasë për të pastrehët që nuk janë të vendosur në strehimoren. Në kuadër të aksionit ka funksionuar edhe ekipe të lëvizës që cili ka patrulluar në gjithë qytetin me veturë të Kryqit të kuq, ka vizituar vendet ku kanë lëvizur të pastrehët dhe u kanë ofruar ndihmë. Është ofruar ndihmë për 60 të pastrehë dhe 20 familje të rrezikuara në pikëpamje sociale.

Kryqi i kuq i R. së Maqedonisë ka marrë pjesë ak-

tivisht edhe në punën e Komisionit për ndryshimet klimatike dhe shëndetin në Ministrinë e Shëndetësisë dhe në përpjekjet e përbashkëta ndër-sektoriale për mbrojtjen e popullsisë në kushte të temperaturave të jashtme në skajshmëri.

Përgatitja e planit të veprimit për shëndetin seksual dhe reprodaktiv në kushte të krizës

Nën koordinimin e UNFPA dhe Ministrisë së Shëndetit, dhe me pjesëmarrjen e përbashkët të shumë institucioneve dhe organizatave, si: Instituti i Shëndetit Publik, Qendra për Menaxhimin e Krizave, Drejtorija për Mbrojtje dhe Shpëtim, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Kryqi i kuq i R. së Maqedonisë, OJQ Hera, OJQ La strada, UNDP, të cilat kanë qenë të përfshira në mënyrë aktive në përballjen me krizën migruese, është përgatitur plani i veprimit për shëndetin seksual dhe reprodaktiv në kushte të krizës. Plani ka të bëjë me periudhën e vitit 2016. Janë përgatitur procedurat operative standarde për klinikën gjinekologjike lëvizëse në qendrat transitore.



Ndërtimi i kapaciteteve të organizatave komunale për dhunën në baza seksuale dhe gjinore dhe mbështetja psiko-sociale

Në periudhën 12.09-14.09.2016 në qendrën e trajnimit Solferino në Strugë është zhvilluar punëtorja mbi dhunën në baza seksuale dhe gjinore dhe mbështetja psiko-sociale, e mbështetur nga Federata Ndërkombëtare e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuq. Në trajnimin morën pjesë 27 pjesëmarrës nga organizata të shumta komunale të Kryqit të kuq të R. së Maqedonisë: Veles, Kumanovë, Kërçovë, Sveti Nikollë, Manastir, Prilep, Kavadar, Kriva Pallankë dhe Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit.

Trajnimi kishte për qëllim njoftimin dhe marrjen e njohurive për konceptet themelore të dhunës në baza seksuale dhe gjinore (DHBSGJ) dhe përfitimin e shkathtësive për t'ju qasur dhe për të mbështetur personat që kanë përjetuar dhunë familjare.

Në fund të kësaj punëtorie nga ana e pjesëmarrësve janë përcaktuar nevojat dhe prioritetet, si dhe hapat dhe aktivitetet e ardhshme të organizatave komunale të Kryqit të kuq të R. së Maqedonisë në drejtim të forcimit të kapaciteteve dhe veprimit në fushat e dhunës seksuale dhe gjinore dhe mbështetja psiko-sociale për personat që kanë përjetuar këtë lloj të dhunës.

Forcimi i kapaciteteve të organizatave komunale për ngritjen e vetëdijes dhe sensibilizimi i popullsisë për dhurimin e organeve

Përmes realizimit të projektit **“Dhuroni një organ – dhuroni një jetë”** i financuar nga SHA Banka Komerciale Shkup, gjatë vitit 2016 nga Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në bashkëpunim me 10 organizata komunale të Kryqit të kuq: Qendër, Gazi Babë, Manastir, Prilep, Kavadar, Strugë, Veles, Gostivar, Strumicë dhe Koçanë, janë arsimuar 20 vullnetarë të mbështetur në mënyrë profesionale nga prof. Dr. Goce Spasovski i Klinikës së nefrologjisë në Shkup

Për nevojat e projektit janë përgatitur materiale informative-publikuese në formë të flajerëve, posterëve, pyetësorëve anketues, banerëve dhe një TV-spot.

Në organizim të 10 OKKK-ve janë realizuar edhe 20 punëtori dhe tribuna arsimore me grupe të ndryshme qëllimore, me sektorin e OJQ-ve, me të rinj, me pjesëtarë të ARM-së, pjesëtarë të policisë, përfaqësues të institucioneve shëndetësore, arsimore dhe sociale, pensionistë, bashkësi fetare, kompani, persona të transplantuar etj. Të pranishmit në këto punëtori dhe tribuna patën mundësinë për t'u njohur dhe për të marrë shumë informacione lidhur me temën, mundësitë për të dhuruar organe, problematikën, rregullat ligjore dhe mendimet religjioze mbi këtë temë.

Parandalimi dhe zbulimi i hershëm i diabetit dhe osteoporozës te popullsia e mjediseve rurale – “Në kontroll dhe parandalim të sëmundjes së sheqerit dhe osteoporozës”

Parandalimi dhe zbulimi i hershëm i diabetit dhe osteoporozës te popullsia e mjediseve rurale – “Në kontroll dhe parandalim të sëmundjes së sheqerit dhe osteoporozës” është një projekt të cilin Kryqi i kuq e zbatoi në



popullsinë e mjediseve rurale: f.Konjari i Vogël në Prilep, f.Podarësh në Radovish dhe në Komunën Konçe. Aktivitetet e realizuara kishin për qëllim arsimimin e kësaj popullsie për zbulimin e hershëm të simptomave të sëmundjes së sheqerit dhe osteoporozës, dhe realizimin e kontrolleve preventive me aparatën denzinometër për zbulim të hershëm të osteoporozës dhe matjen e nivelit të sheqerit në gjak. Të gjithë qytetarëve të pranishëm gjatë ligjëratave u janë dhënë materiale informative-arsimore.

Projekti është financuar nga ana e Kompanisë Alians Uan e Kavadarit, ndërkaq Kryqi i kuq i R. së Maqedonisë këtë projekt e ka realizuar në bashkëpunim me një ekip profesional të Klinikës së endokrinologjisë dhe Shoqatën e osteoporozës së Maqedonisë.

Gjithsej me këtë projekt janë realizuar 217 kontrolle skringu për osteoporozë dhe janë zbuluar 55 raste me osteoporozë.

Nga gjithsej 246 matje të bëra të nivelit të sheqerit në gjak tek 67 persona është zbuluar sëmundja e sheqerit. Disa nga këta persona tanimë janë regjistruar si persona me diabet dhe marrin terapinë e përshkruar, por ka edhe raste të sapo zbuluara të sëmundjes së sheqerit që janë dërguar për të bërë test skringu.

NDIHMA E PARË

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë përmes organizatave komunale të Kryqit të kuq dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit gjatë vitit 2016 ka zhvilluar 1.073 kurse të ndihmës së parë për kandidatë për shoferë, në të cilët janë trajnuar gjithsej 15.251 kandidatë për shoferë, janë mbajtur 154 kurse të ndihmës së parë për organizatat e punës në të cilët janë trajnuar 1.002 persona, për dallim nga viti 2015 kur janë mbajtur 1.253 kurse të ndihmës së parë për trajnim të kandidatëve për shoferë në të cilat janë trajnuar 18.568 persona, si dhe 139 kurse të ndihmës së parë për trajnimin e personave të punësuar në organizatat e punës në të cilët janë trajnuar 1.232 persona, që tregojnë për rezultate më të dobëta me numër të ulur për 3.317 kandidatë për shoferë dhe 230 për organizatat e punës.

Gara XXV shtetërore e ekipeve të ndihmës së parë

Në organizim të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë më 16 dhe 17 shtator të vitit 2016 në Kavadar është mbajtur Gara XXV shtetërore e ekipeve të ndihmës së parë me moton “Ndihma e parë për dhe nga fëmijët”.

Në këtë garë kanë marrë pjesë 27 ekipe të organizatave komunale të Kryqit të kuq Berovë, Manastir, Vallandovë, Veles, Dibër, Dellçevë, Kavadar, Kërçovë, Koçanë, Kriva Pallankë, Krushevë, Kumanovë, Negotinë, Ohër, Prilep, Probishtip, Radovish, Resnjë, Sveti Nikollë, Strugë, Strumicë, Shtip, Gazi Babë, Karposh, Kisella Vodë, Qendër dhe Çair.

Për të organizuar garën në mënyrë të suksesshme janë angazhuar 41 gjyqtarë (prej të cilëve 30 doktorë dhe 11 demonstrues), 13 mjeshtër të grimit për shfaqjen reale të plagëve dhe lëndimeve, 30 manekinë/aktorë, 27 udhëheqës ekipesh, 4 vullnetarë për bartjen e listave të pikëve, 6 gjyqtarë të diseminimit dhe të lojërave me karakter argëtues dhe sportiv-rekreativ dhe një komision pesë-anëtarësh për mbledhjen e pikëve. Janë angazhuar një numër i madh i vullnetarëve nga ana e nikoqirit OKKK Kavadar, të punësuar në shërbimin profesional të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë dhe vullnetarë të ekipit të logjistikës së Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë.

Në këtë ngjarje të pranishmëve iu drejtua kryetari i Kryqit të kuq i Republikës së Maqedonisë z. Millço Trajkov dhe kryetari i Organizatës komunale të Kryqit të kuq të Kavadarit z. Dimitar Karakulev.

Vendin e parë në këtë garë e zuri ekipi i ndihmës së parë i OKKK Çair me 910 pikë të fituara, vendin e dytë e zuri ekipi i ndihmës së parë i OKKK Koçanë me 903 pikë, vendi i tretë i takoi ekipit të ndihmës së parë të OKKK Qendër me 902 pikë, në vendin e katërt u plasua ekipi i OKKK Prilep me 894 pikë dhe në vendin e pestë me 888 pikë të fituara u plasua ekipi i OKKK Kisella Vodë. Në bazë të diseminimit më i suksesshëm doli ekipi i OKKK Shtip i cili tregoi njohuri më të mira për lëvizjen, vizionin dhe misionin e Kryqit të kuq.

Realizimi i ushtrimit të simuluar

“Përmbytje me një numër më të madh të lënduarish dhe të mbyturish” Më 26.10.2016 në Veles është zhvilluar një ushtrim i simuluar organizuar nga Ministria e Shëndetësisë e RM-së dhe OSHB-Zyra rajonale në Shkup dhe Kryqi i kuq i R. së Maqedonisë. Në këtë ushtrim morën pjesë: HEM Veles, Spitali i përgjithshëm – Veles, MPB, ZF-Veles, QMK, DMSH, Kryqi i kuq i RM, Organizata komunale Veles.

Qëllimi i ushtrimit ishte ngritja e nivelit të përgatitjes në kushte të krizës, në kuadër të prioritetit për Sigurinë shëndetësore, përgjigjja dhe përgatitja në kushte të krizës.

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në bashkëpunim me Organizatën komunale të Kryqit të kuq Veles ka dhënë kontribut në mbarëvajtjen e këtij ushtrimit, kështu që ka siguruar vullnetarë që aktronin se janë të lënduar, një ekip të shpëtimit në ujë që i nxirrnin të mbyturit nga lumi Vardar, dhe grimerë të cilët në mënyrë reale i shfaqën lëndimet. Me këtë aktivitet, vullnetarët kontribuuan që ushtrimi të jetë në mënyrë të konsiderueshme më real, me kushte dhe situata si në një aksident të vërtetë.



Mbështetja shëndetësore për migruesit

Në periudhën 25-27.03.2016 në qendrën e trajnimit Solferino në Strugë, në kuadër të Projektit për mbështetjen e migruesve të cilët kalojnë transit nëpër R. e Maqedonisë, me mbështetjen financiare të Federatës Ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe është realizuar trajnimi i ndihmës së parë për vullnetarët e rinj. Në të morën pjesë 27 vullnetarë të organizatave komunale të Kryqit të kuq: Qendër, Kisella Vodë, Çair, Gazi Babë, Karposh, si dhe organizatat komunale të KK: Gjevgjeli, Vallandovë, Negotinë, Manastir, Ohër, Strugë, Veles dhe Kumanovë.

Përmes realizimit të këtij trajnimi Kryqi i kuq i R. së Maqedonisë kishte për qëllim forcimin e kapaciteteve të Shoqatës nacionale në fushën e ndihmës së parë për t'u përgjigjur ndaj nevojave jo vetëm të krizës së migruesve por edhe të kushteve të tjera të ardhshme të krizës apo katastrofave.

Pjesëmarrësit e këtij trajnimi patën mundësinë për t'u njohur më afër me aktivitetet e Kryqit të kuq të R. së Maqedonisë si përgjigje ndaj krizës migruese, duke vënë theks në ofrimin e ndihmës së parë për migruesit nga ana e ekipeve lëvizëse.

Përfaqësuesit e pranishëm të qendrës transitore në Kumanovë dhe Gjevgjeli i ndanë përvojat e tyre gjatë ofrimit të ndihmës së parë për migruesit, cilat janë problemet dhe nevojat shëndetësore më të shpeshta të migruesve, kushtet dhe situatat specifike me të cilat janë përballur gjatë punës etj.

Në fushën e arsimit për ndihmën e parë përveç shkathtësive teorike ata përfituan edhe shkathtësi praktike nga temat, kushtet për të cilat do të kishin më së shumti nevojë në terren. Përveç temave kryesore që i përfshinte trajnimi bazik për ndihmën e parë, janë punuar edhe: përdorimi i një defibrilatori të jashtëm automatik "airway", një dërrasë imobilizimi, kafshimi i insekteve dhe gjarpërinjve, goditja e rrymës elektrike, hipo dhe hipertermia.



DHURIMI I GJAKUT

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë dhe Instituti për mjekësi të transfuzionit në vitin 2016 nga 55.000 njësitë e planifikuara të gjakut kanë realizuar 55.909 njësi gjak ose detyrimet e planifikuara i kanë përmbushur me 101.70 %. Për dallim nga viti 2015 kur janë realizuar 54.708 njësi gjak shënojmë rezultate më të mira për 1.201 njësi gjak apo për 2.20 %. Në qytetin e Shkupit organizatat komunale të Kryqit të kuq Gazi Babë, Karposh, Kisella Vodë, Qendër dhe Çair, në vitin 2016 kanë realizuar 19.630 njësi gjak apo obligimet e planifikimit i kanë përmbushur me 125.60 %, dhe në krahasim me vitin 2015 kur janë realizuar 17.368 njësi gjak shënojmë rezultate më të mira për 2.262 njësi gjak. Në organizatat komunale të Kryqit të kuq nga brendësia, në vitin 2016 janë realizuar 36.279 njësi gjak apo në krahasim me vitin 2015 kur janë realizuar 37.340 njësi gjak janë arritur rezultate më i keq për 1.061 njësi gjak. Në Spitalin e përgjithshëm të qytetit "8 Shtatori" në Shkup, në shërbimin e mjekësisë së transfuzionit në vitin 2016 janë realizuar 2.295 njësi gjak dhe krahasuar me vitin 2015 kur janë realizuar 1.967 njësi gjak janë shënuar rezultate më të mira për 328 njësi gjak.

Në Qendrën ditore për dhurimin e gjakut në SHOH "Dare Xhambaz" në Shkup në vitin 2016 janë realizuar gjithsej 2.042 njësi gjak prej të cilave 1.882 me dhurimin e gjakut me vetiniciativë nga qytetarët e Shkupit dhe përmes organizimit të aksioneve për dhurimin e gjakut janë mbledhur 160 njësi gjak. Në krahasim me vitin 2015 kur janë mbledhur gjithsej 2.043 njësi gjak janë shënuar pothuaj se rezultate identike.

Detyrimet e planifikimit për dhurimin e gjakut në vitin 2016 i përmbushën 17 organizatat komunale të Kryqit të kuq si vijon: Manastir 105.50 %, Vallandovë 145.70 %, Veles 212.20 %, Vinicë 201.85 %, Dellçevë 123.97 %, Kavadar 144.69 %, Kratovë 108.20 %, Kriva Pallankë 150.40 %, Krushevë 106.10 %, Negotinë 116.36 %, Probishtip 106.80 %, Sveti Nikollë 215.20 %, Strugë 120.90 %, Shtip 153.90 %, Gazi Babë 168.43 % dhe Qendër 235.90 %.

Ekipi i koordinimit gjatë vitit 2016 ka zhvilluar 108 takime koordinuese dhe ka koordinuar 863 aksione për dhurimin e gjakut në terren.

Është shënuar 17 marsi - Dita e dhurimit të gjakut në R. e Maqedonisë dhe janë dhënë mirënjohje për dhurimin e gjakut për organizatat më të suksesshme komunale të Kryqit të kuq - 17 marsi – Dita e dhurimit të gjakut në Republikën e Maqedonisë është shënuar me aktivitete të rastit në organizatat komunale të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit. Në solemnitetet e organizuara janë dhënë mirënjohje jubilarë për dhuruesit e shumëfish të gjakut, institucionet, kompanitë dhe individët e shquar. Më 16 mars të vitit 2016 në Sallën e Madhe të Komunës së Ohrit, Organizata komunale e Kryqit të kuq të Ohrit ka mbajtur tribunë me temën "Dhurimi



vullnetar i gjakut – nevojë dhe sfidë”.

Më 23 mars në SHOH “Dare Xhambaz” në Shkup është mbajtur një mbledhje e rregullt e Kuvendit të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë në të cilën janë dhënë çmime në të holla për tre të parët e plasuar: OKKK Vinicë, Veles dhe Qendër të cilat shënuan rezultate më të mira në dhurimin e gjakut në vitin 2015, 15 OKKK kanë marrë mirënjohje për planin e përmbushur të dhurimit të gjakut në vitin 2015 dhe OKKK Çair ka marrë mirënjohje për rezultatin më të mirë të shënuar në dhurimin e gjakut në vitin 2015 në krahasim me vitin 2014.

Janë zhvilluar seminare dhe punëtori edukative për dhurimin vullnetar të gjakut - Në periudhën 13-15 maj të vitit 2016 në Strugë është zhvilluar një punëtori edukimi për motivues të rinj për dhurimin vullnetar të gjakut me pjesëmarrje të 25 përfaqësuesve të OKKK-ve. Në punëtorinë janë përpunuar temat në vijim: Dhurimi i gjakut në Republikën e Maqedonisë, Ekipi i koordinimit dhe i punës i Qendrës ditore për dhurimin e gjakut, Gjaku dhe elementet e gjakut dhe aktualitetet në mjekësinë e transfuzionit, Format e organizimit për dhurimin e gjakut – Klubi 25 dhe Klubi i dhuruesve të gjakut, Të ushqyerit sipas grupeve të gjakut, Transmetimi i përvojave dhe shembujve pozi-

tivë të dhurimit vullnetar të gjakut në vendet tjera (prezantimi i spoteve dhe filmave për dhurimin e gjakut), Aspektet psikologjike të dhurimit të gjakut – me theks të veçantë në Komunikimin, Llojet e komunikimit, pengesat në komunikim, faktorët dhe ndjenjat për një komunikim të efektshëm, procesi i të dëgjuarit aktiv dhe aspektet e ekipit dhe punës ekipore. Në fund të punëtorisë përmes pyetjeve të kuizit është bërë verifikimi i njohurive të pjesëmarrësve për përmbajtjet e programit të trajnimit.

Në periudhën 20-22 maj të vitit 2016 në Hotelin “Biser” në Strugë janë zhvilluar lojërat tradicionale sportive-rekreative për dhuruesit e gjakut me pjesëmarrjen e Klubit të dhuruesve të gjakut të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit, NPK Shkup, Rafineria OKTA, Makpetroli, SPIM dhe Bargalla Shtip. Dhuruesit e gjakut kanë garuar në konkurrencën e meshkujve dhe të femrave individualisht dhe në konkurrencë ekipore në disiplinat vrapim në 100 metra, vrapim në thasë, hedhja e gjyles, tërheqja e litarit, pikado, treshe në basketboll, ping-pong dhe ngrënie tortë sfungjer (shampite). Në konkurrencën ekipore vendin e parë me 38 pikë të grumbulluara e zuri Klubi i dhuruesve të gjakut i Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit dhe NPK, ndërkaq vendin e tretë me 34 pikë të grumbulluar e zuri Bargalla Shtip.



Seminari për motivues. Në periudhën 02-04 shtator të vitit 2016 në Strugë është zhvilluar seminari i edukimit të motivuesve për dhurimin vullnetar të gjakut. Në seminarin morën pjesë 30 pjesëmarrës – motivues të rinj të Klubeve 25 të Organizatës së qytetit të Kryqit të kuq të Shkupit, organizatat komunale të Kryqit të kuq të Manastirit dhe Ohrit, të rinjtë e Klubit 25 të Kryqit të kuq të Shqipërisë dhe Klubi 25 i Organizatës së qytetit të Kryqit të kuq të Novi Sadit nga Republika e Serbisë, dhe 12 anëtarë të Klubit të dhuruesve të gjakut të Kryqit të kuq të Shkupit. Përfitimi special i seminarit ishte mundësia për të këmbyer përvojat me përfaqësuesit e Shqipërisë dhe Serbisë dhe ndërtimi i miqësive midis pjesëmarrësve – si mundësi për një bashkëpunim të ardhshëm të përbashkët në fushën e dhurimit vullnetar të gjakut. Seminari ishte një mundësi për të marrë informacione të reja dhe për të mësuar përmbajtje të reja për dhurimin e gjakut, për t'u informuar në mënyrë të ndërsjellë për aktivitetet e Klubeve 25 dhe për të ndarë përvojat pozitive ndërmjet vete.

Është shënuar 14 qershori – Dita botërore e dhurimit të gjakut - Më 14 qershor të vitit 2016 me moton **Gjaku na lidh të gjithëve – Ndaj jetë, dhuro gjak!**, Kryqi i kuq i RM-së, Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit në bashkëpunim me Institutin e mjekësisë së transfuzionit kanë shënuar Ditën botërore të dhurimit të gjakut. Ngjarja qendrore është realizuar në QTQ Shkup. Aktiviteti është pjesë e

projektit “Klubet shkollore për edukim dhe preventivë” dhe është mbështetur nga Transmet – Shkup. Janë ekspozuar 33 zgjidhje ideore me karakter ndërkombëtar (Maqedonia, India, Kina, Irani, Ekuadori, Polonia, Australia). Në ngjarjen ishin të pranishëm vullnetarët e Klubit 25 dhe Klubit të dhuruesve të gjakut të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit. .

Pjesëmarrja në punëtorinë ndërkombëtare për dhurimin vullnetar të gjakut - Në periudhën 08-10 tetor të vitit 2016 është mbajtur Punëtorja rajonale për dhurimin e gjakut në Berat – Republika e Shqipërisë me moton “Së bashku mund të realizojmë 100% dhurim vullnetar të gjakut”. Pjesëmarrës në këtë punëtorinë ndërkombëtare ishin përfaqësuesit e Kryqit të kuq të Shqipërisë, Italisë, Maqedonisë dhe Kosovës. Përmes prezantimeve janë paraqitur aktivitetet në veprimtarinë e dhurimit të gjakut edhe të Klubeve 25. Punëtorja ishte një mundësi për të marrë informacione të reja, për të mësuar përmbajtje të reja për dhurimin vullnetar të gjakut, për të informuar të rinjtë për aktivitetet e Klubit 25, mënyrat e planifikimit, organizimit dhe kryerjes së aksioneve për dhurimin e gjakut, për t'u njohur me mënyrën e inkurajimit të dhuruesve të rinj, vendosjen e kontakteve me dhurues të rregullt të përhershëm dhe promovimin e dhurimit vullnetar të gjakut nëpërmjet rrjetave sociale.

AKTIVITETET E TË RINJVE

Në vitin 2016 vullnetarët e rinj të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë janë përfshirë në mënyrë aktive në përgjigjen ndaj sfidave humanitare me të cilat u përball Republika e Maqedonisë. Si përgjigje për lëvizjen migruese dhe katastrofat natyrore që e kapluan vendin tonë (përmbytjet, valët e ftohta, valët e ngrohta) në kuadër të klubeve të të rinjve në organizatat komunale të Kryqit të kuq dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit janë organizuar një numër i madh edukimesh, aksione grumbullimi për mbështetje, vizita në terren për të vlerësuar dëmet, shpërndarje të ndihmave, këshillime etj, në drejtim të zbutjes së pasojave dhe parandalimit të përkeqësimit të gjendjes..

Me kreativitetin dhe aktivitetin e tyre inventiv të rinjtë dhanë kontribut të madh në aktivitetet e përgjithshme të Shoqatës nacionale për mbështetjen e popullsisë së rrezikuar dhe në mënyrë masive u përfshinë në implementimin e aktiviteteve në situata emergjente.

Në periudhën 07-14.07.2016 është organizuar

një trajnim nacional për menaxhimin me vullnetarët e rinj në kuadër të kampit veror tradicional për të rinj "100% Kryq i kuq". Gjithsej 87 pjesëmarrës të 26 klubeve për të rinj kanë pasur mundësinë për të marrë njohuri dhe shkathtësi të reja për të vepruar në mënyrë më efektive në klubet e të rinjve në drejtim të përmbushjes së dispozitave strategjike të organizatës.

Aktivitetet për të plotësuar nevojat e popullsisë së rrezikuar duke filluar nga 31.12.2016, në 31 klube rinore (nga gjithsej 35) të OKKK-ve dhe KKQSH-së aktive janë 2037 vullnetarë të rinj që është një rritje për 190 vullnetarë për këto klube në krahasim me vitin e kaluar.

Vullnetarët e rinj janë pjesë integrale e punës së përgjithshme të Shoqatës nacionale. Përveç aktiviteteve të veta në kuadër të klubeve rinore janë organizuar edhe punëtoritë e mëposhtme edukative në vitin 2016:

Punëtoritë edukative për preventivë dhe ngritje të vetëdijes

Tema	Numri i përgjithshëm i punëtorive të zhvilluara	Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve
Parandalimi i HIV/SIDA dhe SPI	113	4060
Parandalimi i tregtisë me njerëz	83	2146
Parandalimi i sëmundjeve që shkaktojnë varshmëri	277	7758
Ndihma e parë	124	2850
Promovimi i dhurimit të gjakut	11	328
Diseminimi	111	2429
Parandalimi i tuberkulozit	13	816
Mbrojtja shëndetësore e dhëmbëve	33	930
Ngritja e vetëdijes për migruerit	25	522
Shprehitë e shëndetshme jetësore	19	672
Punëtori të tjera të parandalimit	5	127

Në gjithsej 814 punëtori edukative janë përfshirë 22 638 pjesëmarrës.

Në gjithsej 24 organizata komunale të Kryqit të kuq janë organizuar gara komunale të ndihmës së parë ku aktivisht kanë marrë pjesë 1636 nxënës të shkollave fillore dhe të mesme.



MOBILIZIMI I FONDEVE TË SEKTORIT TË KORPORATAVE

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë vitin e kaluar realizoi bashkëpunim me disa kompani të rëndësishme të vendit që praktikojnë punë të përgjegjshme shoqërore dhe ato kanë siguruar mbështetjen e projekteve dhe aktiviteteve programore për të ndihmuar grupet qëllimore të popullsisë së rrezikuar në vend.

Në vitin 2016 është realizuar një bashkëpunim me shtatë kompani të mëdha dhe me disa kompani të mesme dhe të vogla në vend. Mbështetja e kompanive të mëdha për implementimin e projekteve dhe aktiviteteve programore të Kryqit të kuq të RM-së ishte në vlerë të përgjithshme 5.227.500 denarë që përfaqëson një kontribut të rëndësishëm në realizimin e qëllimeve humanitare të organizatës.

Vitin e kaluar një numër i madh i kompanive të vendit kanë ofruar mbështetjen në aksionin humanitar të Kryqit të kuq të RM-së që e kishte organizuar për të ndihmuar popullsinë e rajoneve të përmbytura në Shkup dhe Tetovë. Janë dhuruar mjete në të holla dhe ndihmë në mallra dedikuar për popullsinë e goditur nga përmbytjet.

Kryqi i kuq i RM-së gjatë vitit realizoi bashkëpunim me Odën ekonomike të RM-së, Lidhjen e odave ekonomike të RM-së, Odën ekonomike të Maqedonisë perëndimore, Odën ekonomike amerikane dhe Odën e zejtarëve të qytetit të Shkupit, odat ekonomike vendore, për të mbështetur aktivitetet e projektit dhe programit, që mundësuan mbështetjen e anëtarëve të tyre për implementimin e aktiviteteve humanitare të Kryqit të kuq.

KOMPANITË	Mbështetja e siguruar për aktivitetet e projektit dhe programit
EVN MAQEDONI SHA	Mbështetja e projektit Kujdesi për të moshuarit në kushte shtëpiake që u zbatua nga Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit dhe organizatat komunale të Kryqit të kuq: Veles, Kriva Pallankë, Kërçovë, Dibër dhe Strugë, ku janë përfshirë gjithsej 402 persona të moshuar dhe të dobët. Mbështetja për organizimin e aksionit për matjen falas të sheqerit në gjak në kuadër të shënimit të Javës së kujdesit për të moshuarit. Është implementuar aksioni i përbashkët humanitar "Të ndajmë gëzim" – janë dhënë dhurata për Vitin e Ri për 320 fëmijë me nevoja të veçanta dhe fëmijë të familjeve të rrezikuara në aspekt social në tetë komuna në vend.
BANKA KOMERCIALE SHA Shkup	Mbështetja e projektit për Përmirësimin e socializimit të fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të veçanta (340 fëmijë) i zbatuar nga shtatë organizata komunale të Kryqit të kuq dhe Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit.
TRANSMET Shpk Shkup	Mbështetja e projektit "Klubet shkollore të edukimit dhe preventivës së Kryqit të kuq" i zbatuar nga Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit.
FONDACIONI DAUTI	Mbështetja e aktiviteteve për "Qendrën ditore për të moshuarit dhe për qendrën për dhënie dhe ndihmë në kushte shtëpiake" që janë zbatuar përmes Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit.
ALIANI UAN МАКЕДОНИЈА, KAVADAR	Mbështetja e projektit "Në kontroll dhe parandalim të sëmundjes së sheqerit dhe osteoporozës", i realizuar në tre mjedise rurale përmes Kryqit të kuq të RM-së.
Fondacioni T-MOBILE për Maqedoninë	Është siguruar një numër falas për donacione
One.Vip	Janë siguruar numra falas për donacione

Takimi i partneritetit

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë më 24 nëntor në Panairin e Shkupit ka mbajtur Takimin e shtatë partneritetit. Takimi është organizuar për të promovuar vlerat dhe kapacitetet humanitare të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë për inkurajimin e partneriteteve strategjike për implementimin e iniciativave të

përbashkëta shoqërore për përmirësimin e cilësisë së jetës së popullsisë së rrezikuar. Në takimin e partneritetit morën pjesë sektori i korporatave, organizata dhe agjenci ndërkombëtare në vendin tonë, si dhe përfaqësues të odave ekonomike të Republikës së Maqedonisë.

Tanimë disa vjet praktikë e Kryqit të kuq të RM-së është dhënia e mirënjohjeve përkatëse në shenjë

falënderimi për partnerët për bashkëpunimin dhe mbështetjen e realizuar të partneritetit. Me këtë rast në takimin e partneritetit është dhënë mirënjohja e Kryqit të kuq të RM-së – “Mbështetësi i bronzë” për Fondacionin Albiz për bashkëpunimin dhe mbështetjen e partneritetit në implementimin e aktiviteteve të projektit lidhur me kujdesin për të moshuarit në kushte shtëpiake që janë realizuar përmes Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit. Vitin e kaluar me mbështetjen e Fondacionit është hapur edhe një qendër ditore për të moshuarit për të ofruar ndihmë në kushte shtëpiake në komunën Saraj.

Në këtë takim është prezantuar katalogu i projekteve të Kryqit të kuq që kishte për qëllim nxitjen e interesimit të partnerëve për të vepruar në mënyrë të përbashkët dhe për të vendosur partneritete strategjike në sfera të caktuar me interes të ndërsjellë.



SHËRBIMI PËR KËRKESA

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë që nga fillimi i krizës migruese është përfshirë aktivisht në realizimin e aktiviteteve për rivendosjen e lidhjeve familjare, kështu që në të dyja qendrat e transitit, "Vinojug" dhe "Tabanoc" vazhdimisht veprojnë ekipet lëvizëse që ndjekin gjendjen dhe nevojat e migruarëve për rivendosjen e lidhjeve të ndërprera familjare. Në bashkëpunim me Komitetin ndërkombëtar të Kryqit të kuq dhe shoqatat nacionale të Kryqit të kuq, veçanërisht me shoqatat nacionale të rrugës ballkanike, por edhe me ato që janë destinacioni i fundit i migruarëve, vitin e kaluar janë arritur rezultate të rëndësishme në pjesën e ngritjes së kapaciteteve të Shërbimit për kërkesa të Kryqit të kuq të RM-së, por edhe në pjesën e ofrimit të shërbimeve të këtij shërbimi dhe realizimi i tyre praktik në rastet e shumta të lidhjeve të ndërprera familjare.

Mbështetja për popullsinë migruese

Ekipet për rivendosjen e lidhjeve familjare të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë, gjatë gjithë vitit ishin të pranishme në të dyja qendrat transitore, ku vazhdimisht kishte nevojë për përgjigje ndaj kërkesave të migruarëve në këtë drejtim. Sipas statistikave që janë përgatitur çdo muaj, gjatë vitit 2016 ekipet për rivendosjen e lidhjeve familjare në të dyja qendrat transitore, Vinojug dhe Tabanoc, kanë regjistruar gjithsej 445 kërkesa për shërbime lidhur me rivendosjen e lidhjeve familjare, nga të cilat janë regjistruar 85 raste të lidhjeve të suksesshme të familjeve, prej të cilave 12 të personave të mitur.

Përveç kërkesave që i kanë regjistruar ekipet në qendrat transitore, Shërbimi për kërkesa të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë ka përgatitur databazë të të dhënave për rastet e personave të zhdukur që mbërrinin gjatë gjithë vitit nga shoqatat tjera nacionale. Numri i lutjeve për kërkesa arriti në 554 raste, nga të cilat numri më i madh ishin nga Kryqi i kuq i Gjermanisë 80%, dhe të tjerat kanë mbërritur nga Kryqi i kuq i Serbisë, Kryqi i kuq i Irlandës, Kryqi i kuq i Suedisë dhe Kryqi i kuq i Francës.

Me mbështetjen financiare nga ana e Komitetit ndërkombëtar të Kryqit të kuq gjatë vitit 2016 janë furnizuar dy kontejnerë për nevojat e ekipeve për rivendosjen e lidhjeve familjare dhe një gjenerator i energjisë elektrike për nevojat e ekipit në Tabanoc. Skaj linjës hekurudhore Shkup-Tabanoc janë vendosur 8 tabela të reja me paralajmërim për migruarët që ilegalisht kalojnë vendin tonë, që ishte rast i shpeshtë pas mbylljes së rrugës ballkanike.

Në muajin mars të vitit 2016 si pjesë e Apelit të Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe për mbështetjen e Shoqatës nacionale për t'u ballafaquar me krizën migruese, është mbajtur trajnim i vullnetarëve për punë në Shërbimin për kërkesa. Në trajnimin janë trajnuar 25 vullnetarë të 20 organizatave komunale të Kryqit të kuq dhe të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit.

Konferenca Evropiane për rivendosjen e lidhjeve familjare

Nga 20 deri më 23 prill, Kryqi i kuq i Bosnjës dhe Hercegovinës ishte nikoqir i Konferencës Evropiane për rivendosjen e lidhjeve familjare, ku morën pjesë mbi 100 përfaqësues të 40 shoqatave nacionale të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe. Diskutimet u zhvilluan drejt mënyrave të implementimit të Strategjisë për rivendosjen e lidhjeve familjare 2008-2018 dhe arsyetimit të aktiviteteve të deritashme për rivendosjen e lidhjeve familjare.

Trajnimi në organizim të Kryqit të kuq

Për shkak të vazhdimësisë së ngritjes së kapaciteteve të Shërbimit për kërkesa të Kryqit të kuq të



RM-së, me ftesë të Kryqit të kuq të Gjermanisë, një përfaqësues i Kryqit të kuq të RM-së më 07.10.2016 ka marrë pjesë në trajnimin njëditor *Plotësimi i formularit për të dhënat personale të personave për të cilët supozohet se janë të vdekur*. Kryqi i kuq i Gjermanisë këtë trajnim e ka organizuar në bashkëpunim me Zyrën e Komitetit ndërkombëtar të Kryqit të kuq në Paris, dhe nevoja për të organizuar trajnimin doli nga rastet gjithnjë e më të shpeshta të kërkesave të personave që për një periudhë të gjatë kohore nuk kanë pasur kontakt me të afërmit e tyre dhe për ta supozohet se kanë vdekur rrugës për në vendet e Evropës Perëndimore, veçanërisht në fatkeqësitë e anijeve që ndodhin në bregun grek dhe italian.

Takimi rajonal për rivendosjen e lidhjeve familjare

Tanimë tre vjet me radhë Kryqi i kuq i RM-së është nikoqiri i kësaj ngjarjeje, të cilën sivjet e kemi emëruar si Takim rajonal me temën *Krizë migruese – sfidë e re për thellimin e bashkëpunimit rajonal në planin e rivendosjes së lidhjeve familjare*. Ngjarja ishte organizuar me mbështetjen e Save the children, të cilët sivjet financojnë një pjesë të aktiviteteve të Shërbimit për kërkesa të KKRМ, ndër të cilat edhe Takimin rajonal në të cilin morën pjesë përfaqësues të Komitetit ndërkombëtar të Kryqit të kuq, të Kryqit të kuq të Serbisë, Sllovenisë, Kroacisë, Malit të Zi dhe Bullgarisë, si dhe përfaqësues nga të gjitha institucionet dhe organizatat partnere të

cilat së bashku me Kryqin e kuq veprojnë në terren, siç janë Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, QMK, Ministria e Punëve të Brendshme, UNHCR, UNICEF, Save the children, SOS, Lastrada, IOM, Legis dhe NUN.

Trajnimi për rifreskimin e njohurive

Në periudhën nga 06 deri më 09.12.2016 në Beograd, ekipet për rivendosjen e lidhjeve familjare të "Vinojug"-ut dhe "Tabanoc"-it kanë marrë pjesë në trajnimin për rifreskimin e njohurive të marra më parë. Qëllimi i këtij trajnimi ishte ripërtëritja e njohurive të mëparshme dhe e punës së Shërbimit për rivendosjen e lidhjeve familjare në terren dhe në nivelin koordinues. Temat për shtjellimin e punëtorisë ishin mjetet që përdoren gjatë punës së përditshme, si: promovimi dhe arsyetimi i raporteve mujore, lutjet për kërkesa (shumë lloje, varësisht nga rasti), Daily Phone Logs, FLEXTRANET, Trace the Face, Trace the face Back Office etj.



RAPORT FINANCIAR PËR VITIN 2016

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë punën e tij e paraqet nëpërmjet raportit financiar i cili përmban të ardhurat dhe shpenzimet e planifikuara dhe të realizuara. Raporti financiar është vërtetim i implementimit të suksesshëm të aktiviteteve të programit dhe të projektit të mbështetura nga partnerët e brendshëm dhe jashtëm të Organizatës.

Puna e Organizatës e prezantuar përmes të dhënave financiare tregon një vit të mbyllur me sukses me realizimin e buxhetit prej 262.18% për dallim nga viti 2015 kur realizimi ishte 542.93%. Të ardhurat personale janë realizuar me 47.26% dhe marrin pjesë me 1.94% nga të ardhurat e përgjithshme të realizuara. Të ardhurat nga organet dhe donatorët janë të ardhura të dedikuara, të cilat në pjesën më të madhe direkt transferohen në organizatat komunale, kur janë përdorur për implementimin e aktiviteteve të projektit. Këto të ardhura janë realizuar me 288.07% dhe shënojnë rritje në terma nominalë në krahasim me vitin 2015 kur janë realizuar 744.88% si rezultat i mbështetjes së ofruar financiare për popullsinë e prekur nga vërshimet në Republikën e Maqedonisë dhe nga kriza migruese që e kaploi vendin tonë. Këto zënë 98.06 nga të ardhurat e përgjithshme të realizuara në vitin 2016.

Në pjesën e shpenzimeve mund të konstatohet se shpenzimi është i kontrolluar dhe i dedikuar, që është qëllimi kryesor i çdo organizate. Nga shpenzimet e realizuara në mënyrë të përgjithshme, shpenzimet funksionale gjegjësisht ato programore shënojnë rritje në krahasim me vitin e mëparshëm dhe arrijnë 94,57%, a shpenzimet e roges arrin 2,23% dhe shpenzimet materiale arrijnë 3,2%. Nga shpenzimet e realizuara në mënyrë të përgjithshme 5,21% kanë të bëjnë me nevojat e qendrës dhe shënojnë rënie në krahasim me vitin e kaluar, 14.32% janë transferuar direkt në organizatat komunale të Kryqit të kuq dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit, ndërsa pjesa tjetër 80,47% janë mjete që janë shpenzuar në Zyrën qendrore dhe kanë të bëjnë me realizimin e aktiviteteve programore të organizatave komunale të KK dhe KK të qytetit të Shkupit.

Një pjesë e tepricës së mjeteve financiare apo diferenca pozitive midis të ardhurave dhe shpenzimeve janë mjete të dedikuara që kanë të bëjnë me projektet realizimi i të cilave vazhdon në vitin 2017.

Nga ana e Këshillit ekzekutiv të Kryqit të kuq të RM-së është krijuar një komision, i cili ka kryer revizionin e brendshëm të punës financiare dhe materiale. Gjithashtu është angazhuar një shtëpi e jashtme e pavarur e revizionit, e cila ka kryer revizionin në përputhje me Ligjin e revizionit dhe Standardet ndërkombëtare të njoftimit financiar dhe dispozitat e kontabilitetit që vlejné në Republikën e Maqedonisë. Sipas mendimit të shtëpisë së revizionit gjendja financiare e organizatës Kryqi i kuq i RM-së është paraqitur në mënyrë reale dhe objektive.

Raporti financiar ka të bëjë vetëm me punën e Zyrës qendrore të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë.



RAPORT FINANCIAR PËR VITIN 2016

	Buxheti 2016	Realizuar 2016	% në 2016	% në 2015
TË ARDHURAT E PËRGJITHSHME	173,157,195.00	453,983,755.00	262.18	542.93
Burimet vetanake të të ardhurave	18,618,800.00	8,799,782.00	47.26	169.23
Të ardhurat nga organet / donatorët	154,538,395.00	445,183,973.00	288.07	744.88

	Buxheti 2016	Realizuar 2016	% në 2016	% në 2015
SHPENZIMET E PËRGJITHSHME	173,157,195.00	424,216,024.00	244.99	363.77
Pagat dhe kompensimet e të punësuarve	10,364,416.00	9,454,775.00	91.22	92.87
Shpenzimet për materialet dhe shërbimet	6,395,138.00	13,569,101.00	212.18	216.42
Shpenzimet funksionale (programore)	156,397,641.00	401,192,148.00	256.52	482.67
DALLIMI	0.00	29,767,731.00		

TË ARDHURAT

PËRSHKRIMI	Burimet vetanake të të ardhurave	Të ardhurat nga organet / donatorët	Buxheti 2016	Realizuar nga burimet vetanake	Realizuar nga organet dhe donatorët	Realizuar 2016
74 TRANSFERET DHE DONACIONET						
741 Ministria e Punës dhe Politikës Sociale	6,000,000.00		6,000,000.00		6,000,000.00	6,000,000.00
741 Dhurimi i gjakut (Ministria e Shëndetësisë)		6,763,000.00	6,763,000.00		6,763,000.00	6,763,000.00
742 Veprimtaria sociale-humanitare	200,000.00		200,000.00	175,884.00	13,200,150.00	13,376,034.00
742 Organizimi dhe zhvillimi		9,011,908.00	9,011,908.00		5,905,023.00	6,080,907.00
742 Ndhima e parë	2,500,000.00		2,500,000.00	3,236,303.00		3,236,303.00
742 Edukimi shëndetësor		5,633,287.00	5,633,287.00		6,042,563.00	6,042,563.00
742 Të rinjtë	420,000.00		420,000.00	165,000.00		165,000.00
742 Katastrofat		110,000,000.00	110,000,000.00		227,229,931.00	227,229,931.00
742 Diseminimi			0.00			0.00
742 KK në aksion - PVH		200,000.00	200,000.00			0.00
742 Informimi dhe komunikimi			0.00			0.00
742 Shërbimi për kërkesa			0.00		2,350,979.00	2,350,979.00
742 Reparti ndërkombëtar / bashkëpunimi ndërkombëtar			0.00			0.00
742 Mobilizimi i fondeve		13,030,200.00	13,030,200.00			0.00
742 Financat (të ardhura të tjera)/kredi për veturë/ ndalesa nga të punësuarit, kamata/			0.00		59,898.00	59,898.00
72 TË ARDHURAT JOTATIMORE						0.00
725 Nga OKKK (në bazë të taksës së kotizimit)	1,500,000.00		1,500,000.00	1,369,380.00		1,369,380.00
725 Donacionet nga personat fizikë	200,000.00		200,000.00		68,147.00	68,147.00
725 Donacionet nga personat juridikë shitja e automjeteve	500,000.00		500,000.00			0.00
725 Pagesa shtesë e markave (nga ligji i KK)	300,000.00		300,000.00	176,817.00		176,817.00
723 Nga të hollat e dhënies me qira të lokaleve afariste/ të ardhura të tjera/ të ardhura nga shitja e mjeteve kapitale	1,918,800.00		1,918,800.00	3,676,398.00		3,676,398.00
725 Nga regjistrimi i automjeteve	1,030,000.00	9,900,000.00	10,930,000.00		10,585,845.00	10,585,845.00
725 Të ardhura të tjera/të ardhura nga kamata//Fondi i solidaritetit/Fondi i zhvillimit/pvh	50,000.00		50,000.00		80,542,545.00	80,542,545.00
725 Të ardhurat e bartura nga viti i mëparshëm	4,000,000.00		4,000,000.00		86,435,892.00	86,435,892.00
TË ARDHURAT E PËRGJITHSHME	18,618,800.00	154,538,395.00	173,157,195.00	8,799,782.00	445,183,973.00	453,983,755.00

SHPENZIMET

PËRSHKRIMI	Burimet vetanake të të ardhurave	Të ardhurat nga organet / donatorët	Buxheti 2016	Realizuar nga burimet vetanake	Realizuar nga organet dhe donatorët	Realizuar 2016
SHPENZIMET AKTUALE						
401 PAGAT DHE KOMPENSIMET THEMELORE	7,959,880.00	2,374,536.00	10,334,416.00	5,900,396.00	3,444,202.00	9,344,598.00
402 KONTRIBUTET NGA PAGAT DHE TATIMI PERSONAL	30,000.00	0.00	30,000.00	44,804.00	65,373.00	110,177.00
SHPENZIMET E PËRGJITHSHME PËR PAGAT	7,989,880.00	2,374,536.00	10,364,416.00	5,945,200.00	3,509,575.00	9,454,775.00
420 SHPENZIMET RRUGORE DHE DITORE	70,000.00	0.00	70,000.00	483,491.00	2,362,976.00	2,846,467.00
421 SHËRBIKIMET KOMUNALE	1,065,000.00	0.00	1,065,000.00	104,776.00	749,582.00	854,358.00

422	NGROHJA	625,000.00	0.00	625,000.00	201,730.00	204,295.00	406,025.00
423	KOMUNIKIMI DHE TRANSPORTI	1,520,000.00	1,601,596.00	3,121,596.00	1,083,357.00	2,630,277.00	3,713,634.00
423	MATERIALET	1,119,346.00	2,839,815.00	3,959,161.00	3,034,859.00	7,079,289.00	10,114,148.00
424	MIRËMBAJTJA AKTUALE	962,000.00	0.00	962,000.00	2,154,419.00	2,151,576.00	4,305,995.00
425	SHËRBIKET KONTRAKTUALE	3,193,792.00	8,079,035.00	11,272,827.00	4,667,816.00	18,858,868.00	23,526,684.00
426	SHPENZIMET TJERA OPERATIVE	400,000.00	0.00	400,000.00	429,226.00	185,471,766.00	185,900,992.00
463	TRANSFERET PËR ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE	0.00	33,117,195.00	33,117,195.00	0.00	60,727,155.00	60,727,155.00
SHPENZIMET E PËRGJITHSHME AKTUALE		8,955,138.00	45,637,641.00	54,592,779.00	12,159,674.00	280,235,784.00	292,395,458.00

SHPENZIMET KAPITALE

483	BLERJA E MOBILJEVE DHE PAJISJEVE TË ZYRAVE	0.00	800,000.00	800,000.00	901,017.00	9,502,185.00	10,403,202.00
483	BLERJA E AUTOMJETEVE	0.00	0.00	0.00	649,518.00	8,210,315.00	8,859,833.00
481	MIRËMBAJTJA THEMELORE DHE SPECIALE	400,000.00	0.00	400,000.00	1,523,992.00	16,039,325.00	17,563,317.00
SHPENZIMET E PËRGJITHSHME KAPITALE		400,000.00	800,000.00	1,200,000.00	3,074,527.00	33,751,825.00	36,826,352.00
NDIHMAT, DONACIONET DHE DETYRIMET TJERA		0.00	107,000,000.00	107,000,000.00	0.00	85,539,439.00	85,539,439.00
GJITHSEJ NDIHMAT, DONACIONET DHE DETYRIMET E TJERA		0.00	107,000,000.00	107,000,000.00	0.00	85,539,439.00	85,539,439.00



SHPENZIMET E PËRGJITHSHME		17,345,018.00	155,812,177.00	173,157,195.00	21,179,401.00	403,036,623.00	424,216,024.00
----------------------------------	--	----------------------	-----------------------	-----------------------	----------------------	-----------------------	-----------------------

Shërbimi Financiar
Zhaklina Popoviq



Sekretari i përgjithshëm
d-r Sait Saiti

transferet në OKKK	60,727,155.00	14.32
shpenzimet për qendrën	22,114,497.00	5.21
shpenzimet nga qendra për OKKK	341,374,372.00	80.47
suma	424,216,024.00	100.00

TË HYRAT E PËRGJITHSHME TË REALIZURA NË VITIN 2016



TË DALURA NË VITIN 2016



RAPORTI I REVIZORIT TË PAVARUR

Për:

Udhëheqjen e

KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

SHKUP

Në kemi kryer revizionin e raporteve financiare të "KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË" (në tekstin e mëtejshëm Organizata), të cilat përfshijnë Bilancin e gjendjes së ditës 31 dhjetor të vitit 2016, si dhe Bilancin e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe Raportin e ndryshimeve në fondin e biznesit për vitin që përfundon në atë ditë dhe raportet e politikave më të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënimet tjera shpjeguese.

Raportet e mbyllura financiare për vitin 2016 konsistojnë në raportet e punës së rregullt të Organizatës dhe në raportet e projekteve: 1) Fushata për HIV/AIDS; 2) Kryqi i Kuq i Austrisë; 3) Fondi global për të mbajtur një përhapje të ulët të HIV/AIDS në RM; 4) Federata ndërkombëtare e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe; 5) Ndërmarrja e aksioneve për përfshirjen sociale të personave të moshuar; 6) Intervenimet DOTS në RM; 7) Promovimi i vlerave humane; 8) Kryqi i kuq i Gjermanisë; 9) Aftësia konkurruese në tregun e punës dhe raportet për të dy fondet: 1) Fondi i Zhvillimit dhe 2) Fondi i Solidaritetit, si dhe llogaria për donacionet nëpërmjet rrugës elektronike. Projektet janë financuar nga donatorë të veçantë dhe ato janë realizuar nëpërmjet llogarive të veçanta të Organizatës. Organizata nuk përgatit raporte financiare të veçanta për çdo projekt.

Përgjegjësia e udhëheqjes për raportet financiare

Udhëheqja e Organizatës është përgjegjëse për përgatitjen dhe prezantimin objektiv të këtyre raporteve financiare në përputhje me Ligjin e kontabilitetit për organizatat jofitimprurëse dhe për standardet e raportimit financiar në bazë të parave të gatshme. Kjo përgjegjësi përfshin: formësimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e kontrollit të brendshëm që është i rëndësishëm për përgatitjen dhe prezantimin objektiv të raporteve financiare që janë pa gabime materiale, pa marrë parasysh nëse janë rezultat i një mashtrimi apo gabimi, i një zgjedhjeje apo aplikimi të politikave të duhura të kontabilitetit, si dhe bërja e vlerësimeve të kontabilitetit që janë të arsyeshme për rrethanat.

Përgjegjësia e revizorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim mendimin për këto raporte financiare në bazë të revizionit tonë. Revizionin e kemi kryer në përputhje me Standardet ndërkombëtare të revizionit. Këto standarde kërkojnë nga ne respektimin e kërkesave etike dhe planifikimin dhe kryerjen e revizionit për të marrë vërtetim të arsyeshëm nëse raportimet financiare janë pa gabime materiale.

Revizioni përfshin kryerjen e procedurave për mbledhjen e të dhënave të revizionit për shumat dhe informacionet e dhëna në raportet financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i revizorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve të gabimeve materiale të raporteve financiare, pa marrë parasysh nëse janë rezultat i një mashtrimi ose gabimi. Kur i bën këto vlerësime të rreziqeve, revizori e rishikon kontrollin e brendshëm të rëndësishëm për përgatitjen dhe prezantimin objektiv të raporteve financiare për të formësuar procedurat e revizionit që janë përkatëse për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

Revizioni gjithashtu përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit nga ana e udhëheqjes, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të raporteve financiare.

Në besojmë se të dhënat e revizionit që i kemi mbledhur janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar bazën për mendimin tonë të revizionit.

Mendimi i revizorit

Sipas mendimit tonë raportet financiare të "KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË" japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë në të gjitha aspektet e rëndësishme të pozitës financiare të Organizatës në ditën 31 dhjetor 2016, si dhe në rezultatet e punës së tij dhe ndryshimet në fondet për vitet që përfundojnë në atë ditë, në përputhje me Ligjin e kontabilitetit të organizatave jofitimprurëse dhe standardet për raportimin financiar në bazë të parave të gatshme.

Raporti për kërkesat tjera juridike dhe rregullatore

Udhëheqja e Organizatës është gjithashtu përgjegjëse për përgatitjen e raportit vjetor të punës në përputhje me Ligjin e shoqatave dhe fondacioneve. Përgjegjësia jonë në përputhje me Ligjin e revizionit është të bëjmë me dije nëse raporti vjetor është në përputhje me llogarinë vjetor dhe raportet financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor të vitit 2016. Puna jonë lidhur me raportin vjetor të punës është kryer në përputhje me SNR 720 dhe është kufizuar në njoftimin nëse informacionet historike financiare të paraqitura në raportin vjetor të punës janë në përputhje me llogarinë vjetore dhe raportet e rishikuara financiare.

Raporti vjetor i punës është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me llogarinë vjetore dhe raportet e rishikuara financiare të "KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË"; Shkup për vitin që përfundon më 31 dhjetor të vitit 2016.

Shkup, 6 mars i vitit 2017



Drejtues
Dragan Dimitrov



Revizori i autorizuar
Zvonko Kočovski

WWW.REDCROSS.ORG.MK

 www.facebook.com/CrvenKrstNaRepublikaMakedonija

You  www.youtube.com/MacedonianRedCross